



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 53

2003

Korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8869 datë 22.5.2003	Për Gardën e Republikës së Shqipërisë.....	2111
Ligj nr.9070 datë 22.5.2003	Për disa ndryshime në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", i ndryshuar me ligjet nr.7653, datë 23.12.1992; nr.7723, datë 21.6.1993; nr.7925, datë 19.4.1995; nr.8159, datë 7.11.1996; nr.8306, datë 14.3.1998 dhe nr.8333, datë 23.4.1998.....	2119
Ligj nr.9071 datë 22.5.2003	Për një ndryshim në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim".....	2120
Ligj nr.9072 datë 22.5.2003	Për sektorin e energjisë elektrike.....	2120
Ligj nr.9073 datë 29.5.2003	Për privatizimin e shoqërisë "Uzina Mekanike e Naftës" sh.p.k., Kuçovë.....	2142
Ligj nr.9074 datë 29.5.2003	Për Shërbimin Informativ Ushtarak.....	2143

Ligj nr.9075 datë 29.5.2003	Për miratimin e kritereve dhe të termave kryesorë të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar, të papaguar të Shqipërisë.....	2147
Ligj nr.9076 datë 9.6.2003	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për veprimtaritë e Misionit Vëzhgues të Bashkimit Europian në Republikën e Shqipërisë"	2149
Ligj nr.9078 datë 9.6.2003	Për një shtesë në ligjin nr.8899, datë 22.5.2002 "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG, sh.a.".....	2158
Ligj nr.9079 datë 9.6.2003	Për shfuqizimin e ligjit nr.8720, datë 26.12.2000 "Për krijimin e Policisë Financiare"	2153
Ligj nr.9081 datë 19.6.2003	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale"	2153
Vendim i Kuvendit nr.77, datë 17.6.2003	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr.72, datë 17.3.2003 "Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për hetimin e veprimtarisë së Qeverisë për transparencën e procesit të firmave piramidale në bazë të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë””	2155
Vendim i Kuvendit nr.78, datë 17.6.2003	Për miratimin e Raportit Përfundimtar, konkluzioneve dhe rekomandimeve të Komisionit Hetimor Parlamentar të ngritur me vendimin nr.70, datë 10.3.2003.....	2155
	Rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë, datë 12.6.2003.....	2156
Dekret nr.3866 datë 25.6.2003	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	2157

L I G J
Nr.8869, datë 22.5.2003

PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i misionit, i organizimit të Gardës së Republikës të Shqipërisë dhe i statusit të saj.

Neni 2

1. Garda e Republikës së Shqipërisë është strukturë me status të veçantë në Ministrinë e Rendit Publik, që ka për mision ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe të rezidencave, të përcaktuara në këtë ligj. Ajo varet nga Ministri i Rendit Publik.

2. Misioni dhe statusi i Gardës nuk ndryshojnë në gjendje të jashtëzakonshme apo në gjendje lufte.

Neni 3

Garda e Republikës është person juridik, buxheti i së cilës është zë më vete në buxhetin e Ministrisë së Rendit Publik.

Neni 4

Garda e Republikës së Shqipërisë ruan e mbron:

- a) Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, si dhe familjet e tyre.
- b) Personalitetet e huaja, që vijnë në vendin tonë, në rang të njëjtë me personalitetet shqiptare të shkronjës “a” dhe “c”.
- c) Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, zëvendëskryetarët e Kuvendit, anëtarët e Këshillit të Ministrave, Kryetarin e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryetarin e SHISH-it, Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Guvernatorin e Bankës së Shtetit, Avokatin e Popullit, Kryetarin e KQZ-së, kryetarin e partisë më të madhe të maxhorancës parlamentare, kryetarin e partisë më të madhe të opozitës parlamentare dhe Kryetarin e Bashkisë së Tiranës.
- ç) Rezidencat presidenciale, të Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave, si dhe seli e rezidenca të tjera të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
- d) Banesat e personaliteteve të përmendura në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni.

Neni 5

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë ruhet edhe 4 vjet pas lirimt nga funksioni, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri edhe 3 vjet pas lirimt nga funksioni, kurse Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Rendit Publik dhe Kryetari i SHISH-it edhe dy vjet pas lirimt nga funksioni.

2. Për personalitete të tjera, që përmenden në shkronjën “c” të nenit 4, ruajtja e tyre pas lirimit nga funksioni përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Garda e Republikës siguron ruajtjen e mbrojtjen në objekte edhe gjatë veprimtarive ku marrin pjesë Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, grup personalitetesh, të përcaktuara në shkronjën “c” të nenit 4 dhe pjesëtarë të delegacioneve të huaja, siç përcaktohen në shkronjën “b” të nenit 4.

Neni 7

Garda e Republikës kryen ceremonialet me truproja nderi, sipas përcaktimit që bëhet në protokollin e shtetit. Mënyra e kryerjes së shërbimit të truprojes së nderit të Republikës përcaktohet në rregullore të veçantë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 8

1. Garda përbëhet nga komanda qendrore, drejtori dhe struktura të tjera vartëse.
2. Struktura, organizimi, varësia strukturore dhe limiti organik i Gardës së Republikës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik.

Neni 9

Komandanti i Gardës ka autoritetin e plotë të drejtimit e të kontrollit të të gjithë veprimtarisë së Gardës. Ai është përgjegjës para Ministrit të Rendit Publik për përgatitjen dhe gatishmërinë e efektivave të Gardës dhe për realizimin e misionit të saj.

Neni 10

1. Komandanti i Gardës së Republikës emërohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik. Ai përzgjidhet nga radhët e oficerëve madhorë të karrierës të Gardës dhe të Policisë së Shtetit.
2. Komandanti i Gardës lirohet nga detyra kur:
a) jep dorëheqjen;
b) bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi 6 muaj;
c) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për një çështje penale;
ç) tregon paaftësi në përmbushjen e detyrës;
d) arrin moshën për pension.

Neni 11

1. Punonjësit e Gardës, sipas detyrave dhe funksioneve që kryejnë, kategorizohen në gardistë dhe punonjës të nivelit:
të ulët;
të mesëm;
të lartë;
ç) madhor.
2. Punonjës të nivelit të ulët janë nënoficerët gardistë, të cilët shërbejnë për ruajtjen e objekteve dhe të personaliteteve.
3. Punonjës të nivelit të mesëm janë oficerët gardistë, të cilët ruajnë dhe mbrojnë personalitetet dhe objektet e përcaktuara në këtë ligj.

4. Punonjës të nivelit të lartë janë oficerët gardistë, drejtues të shërbimeve dhe të strukturave në Gardë.
5. Punonjës të nivelit madhor janë oficerët gardistë, drejtues të Gardës e të strukturave të saj.

Neni 12

1. Në Gardën e Republikës pranohen shtetasit shqiptarë sipas kritereve të mëposhtme:
 - 1.1. Për gardistët:
 - a) të kenë arsimin e mesëm;
 - b) të mos jenë dënuar penalisht;
 - c) të kenë sjellje të mira qytetare;
 - ç) të jenë të aftë fizikisht dhe me gjatësi jo më të vogël se 1,75 m.
 - 1.2. Për nënoficerët gardistë:

Përveç kushteve të përcaktuara në pikën 1.1 të këtij neni, duhet të kenë kryer shërbimin ushtarak, të jenë diplomuar në Institutin e Policisë ose në kurse të barasvlershme me të dhe të pranojnë nënshkrimin e kontratës.
 - 1.3. Për oficerët gardistë:
 - a) Të jenë diplomuar në Akademinë e Policisë, në Akademinë e Mbrojtjes, ose të jenë me arsim të lartë civil për specialitete të veçanta.
 - b) Të nënshkruajnë kontratën e pranimit.
 - 1.4. Për oficerët e lartë të Gardës:

Përveç kritereve që parashikohen në pikën 1.3, të kenë kryer kurse kualifikimi, në përputhje me funksionin që do të kryejnë.
 - 1.5. Në sektorët mbështetës dhe në ato administrativë të Gardës punësohen edhe persona, të cilët trajtohen sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” apo sipas Kodit të Punës.

Neni 13

- Efektivi i Gardës së Republikës betohet sipas kësaj formule betimi:
- “Si pjesëtar i Gardës së Republikës betohem se do të jem besnik i popullit tim, trim, i disiplinuar, se do të zbatoj kërkesat e Kushtetutës e të ligjeve dhe do të jem i gatshëm përherë, duke mos kursyer as jetën, për kryerjen e detyrës. Ndëshkimi më i rëndë i ligjeve le të më jepet, nëse shkel këtë betim solemn! Betohem!”.

Neni 14

1. Punonjësi i Gardës largohet nga Garda dhe kalon në rezervë kur:
 - a) mbush moshën për pension;
 - b) bëhet i paaftë për punë nga ana shëndetësore për një periudhë kohe mbi 6 muaj me vendim të komisionit mjekësor ose të gjykatës;
 - c) shkurtohet funksioni ose për shkak të ndryshimeve në organikë;
 - ç) kërkon ai vetë, pasi ka plotësuar kushtet e kontratës së pranimit.
2. Punonjësi i Gardës përjashtohet nga Garda kur:
 - a) kryen, në mënyrë të përsëritur, thyerje të rënda të disiplinës;
 - b) nuk paraqitet në detyrë, pa shkaqe të arsyetuara, mbi 7 ditë;
 - c) shkel betimin;
 - ç) është jashtë kritereve të përcaktuara në këtë ligj;
 - d) dënohet penalisht.
3. Marrëdhëniet e punës, të karrierës dhe të ndërprerjes së tyre përcaktohen në rregulloren e personelit të Gardës, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

4. Emërimi dhe shkarkimi i oficerëve madhorë të Gardës bëhet nga Kryeministri me propozim të Ministrit të Rendit Publik.

5. Emërimi dhe shkarkimi i oficerëve të lartë të Gardës bëhet nga Ministri i Rendit Publik me propozimin e Komandantit të Gardës.

6. Emërimi dhe shkarkimi i oficerëve të nivelit të mesëm dhe i nënoficerëve gardistë bëhet nga Komandanti i Gardës.

Neni 15

Në Gardën e Republikës funksionon hierarkia e gradave, rregullimi i të cilave bëhet me ligj të veçantë.

Neni 16

Punonjësit e Gardës ndëshkohen me këto masa disiplinore:

- a) vërejtje;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) gjobë në masën e pagës deri në 5 ditë pune;
- ç) shtyrje e afatit të gradimit deri në një vit;
- d) ulje në detyrë ose në funksion;
- dh) pezullim nga detyra ose nga funksioni deri në 3 muaj, ose deri në përfundimin e çështjes penale;
- e) përjashtim nga Garda e lirim, sipas pikës 2 të nenit 14.

Neni 17

1. Punonjësi i Gardës i nënshtrohet zbatimit të rregullores së disiplinës, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

2. Në Gardë, me urdhër të Ministrit të Rendit Publik, ngrihet dhe funksionon komisioni disiplinor.

Neni 18

1. Punonjësit e Gardës së Republikës i kryejnë detyrat e tyre me uniformë dhe mbajnë shenjat e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Uniforma dhe shenjat dalluese përdoren vetëm gjatë kryerjes së detyrës.

2. Shërbime të veçanta të Gardës, të përcaktuara nga Ministri i Rendit Publik, i kryejnë detyrat me veshje civile ose veshje të përshtatshme, sipas natyrës së shërbimit.

3. Punonjësi i Gardës pajiset me dokument zyrtar identiteti, të cilin e përdor vetëm për shkak të detyrës.

4. Punonjësi në rezervë i Gardës ka të drejtë të përdorë uniformën në raste festash zyrtare dhe ceremonish.

Neni 19

Punonjësit e Gardës i nënshtrohen juridiksionit penal të zakonshëm.

Neni 20

1. Punonjësi i Gardës së Republikës, në shërbim ose për shkak të shërbimit, është i paprekshëm. Fyerjet, kundërshtimet dhe çdo veprim i dhunshëm ndaj tij dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

2. Kur punonjësit të Gardës, për shkak të detyrës, i kërcënohet jeta, familja a prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë. Mënyrat e mbrojtjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

Punonjësi i Gardës, gjatë kryerjes së detyrës, përdor edhe forcën fizike ose mjete teknike të posaçme për të neutralizuar ose për të shmangur persona të veçantë ose grup personash, që nuk u binden kërkesave të tij e që përbëjnë rrezik ose pengojnë kryerjen e shërbimit për ruajtjen e personaliteteve a të objekteve që parashikohen në këtë ligj.

Neni 22

Punonjësit e Gardës, gjatë kryerjes së detyrës, kanë të drejtë të bëjnë verifikimin e identitetit, kontrollin fizik të mjeteve dhe të bagazheve të të gjithë personave që hyjnë në objektet në ruajtje.

Neni 23

Për nevojat e sigurisë ose në kushtet e nevojës ekstreme ndaj personaliteteve të larta shtetërore të vendit dhe të huaja, si dhe gjatë veprimtarive të caktuara, punonjësit e Gardës, vetë a në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor ose me Policinë e Shtetit, bllokojnë pjesë rrugësh a mjedise publike për aq kohë sa është e nevojshme.

Neni 24

1. Punonjësit e Gardës, që kryejnë detyrën e ruajtjes nga afër të personaliteteve, i kërkojnë punonjësit të policisë të bëjnë identifikimin dhe shoqërimin e personave të dyshuar.

2. Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës rregullohet me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 25

Punonjësi i Gardës përdor armën në rastet e përcaktuara në ligjin nr.8290, datë 24.2.1998 “Për përdorimin e armëve të zjarrit”, si dhe në rastet kur sulmohen:

personalitetet e larta shtetërore të vendit dhe të huaja;
rojet dhe objektet në ruajtje.

Neni 26

Për kryerjen e detyrave, punonjësi i Gardës pajiset me armatim dhe mjete teknike të posaçme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Subjektet private dhe shtetërore janë të detyruara t'i lejojnë punonjësit e Gardës së Republikës që të kryejnë detyrat për mbrojtjen e personaliteteve të larta të vendit dhe të huaja, në rastet kur këto personalitete shkojnë pranë këtyre subjekteve, për veprimtari pune ose pushimi. Në këto raste, punonjësi i Gardës që kryen këtë detyrë identifikohet si i tillë.

Neni 28

1. Shërbimet informative dhe ato të Policisë së Shtetit detyrohen t'i japin të dhëna Gardës për një rrezik të mundshëm ndaj personaliteteve të larta shtetërore a ndaj objekteve.

2. Rregullat për shkëmbimin e të dhënave përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Rendit Publik dhe titullarëve përkatës.

Neni 29

Zyrat e protokollit dhe kabinetet e personaliteteve detyrohen të njoftojnë Gardën e Republikës jo më vonë se 24 orë përpara për veprimtarinë e personaliteteve të larta shtetërore të vendit ose të huaja.

Neni 30

Punonjësi i Gardës nuk mund të dypunësohet ose të kryejë veprimtari private.

Neni 31

1. Punonjësi i Gardës, në çdo rrethanë, nuk duhet të silllet dhe të mbajë qëndrime që cenojnë natyrën e depolitizuar të Gardës.

2. Punonjësit të Gardës i ndalohet anëtarësimi dhe pjesëmarrja në veprimtari të partive a të shoqatave politike.

3. E drejta e punonjësit të Gardës për t'u përfaqësuar në organet e zgjedhura rregullohet me ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore.

Neni 32

Punonjësve të Gardës u ndalohet të organizohen në sindikata dhe të ushtrojnë të drejtën e grevës, si dhe të bëjnë grumbullime.

Neni 33

1. Koha e punës e punonjësve të Gardës njësohet me atë të punonjësve të tjerë të administratës publike, me përjashtim të përcaktimeve të shprehura në këtë ligj.

2. Pushimi vjetor për punonjësit e Gardës është 30 deri në 45 ditë kalendarike dhe jepet i shkallëzuar, sipas funksioneve dhe gradave.

3. Kur, për arsye pune a shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai jepet jo më vonë se në muajin shkurt të vitit pasardhës, në të kundërt bëhet kompensimi i tij në vlerë.

4. Punonjësi i Gardës i gëzon këto të drejta edhe në rastet e shërbimit në ditët e pushimeve javore ose në ditët e festave zyrtare.

5. Në rast fatkeqësie familjare, martese ose në raste të tjera të veçanta punonjësit të Gardës i jepet deri në 7 ditë leje e pagueshme ose deri në 2 muaj leje pa të drejtë page.

6. Periudha e lejes pa të drejtë page nuk llogaritet në vjetërsi pune a shërbimi dhe as për efekt të ecurisë në gradë.

7. Kriteret dhe masat e përfitimeve përcaktohen me akte normative të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 34

1. Punonjësi i Gardës, për shkak të përgjegjësisë, vështirësisë dhe rrezikshmërisë së lartë në detyrë, ka përparësi në trajtimin me pagë.

2. Paga e punonjësit të Gardës caktohet në varësi të rolit dhe të gradës që ka fituar, funksionit që kryen, shkallës së rrezikshmërisë dhe vështirësisë, si dhe në varësi të kushteve të tjera, të veçanta, të vendit të punës, të shërbimit dhe të profesionit.

3. Paga mujore e punonjësit të Gardës përbëhet nga paga bazë, shtesa mbi pagën bazë (në

përqindje ose në skemë absolute) dhe kompensimet për privacionet dhe humbjet që i krijohen punonjësit të Gardës për shkak të nevojave të punës e të shërbimit.

4. Paga bazë mujore është fikse dhe përcaktohet sipas funksionit (nivelit) dhe gradës. Punonjësi i Gardës, për natyrë të veçantë shërbimi, përfiton shtesë mbi pagën bazë.

5. Rregullimi i pagave dhe kriteret për dhënien e tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 35

1. Punonjësve të Gardës, për rezultate shumë të larta në stërvitje e gatishmëri, ruajtje e administrim të vlerave materiale e monetare, si dhe kur kryejnë detyra me rreziqe për jetën e tyre, u jepet shpërblim.

2. Kriteret dhe masa e shpërblimit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 36

1. Punonjësit të Gardës, në rast pamundësie punësimi të bashkëshortes, i jepet ndihmë financiare në raport me pagën minimale në shkallë vendi dhe për fëmijët që ka në ngarkim.

2. Periudha e trajtimit me këtë ndihmë financiare njihet periudhë sigurimi për bashkëshorten.

Neni 37

1. Punonjësi i Gardës, në rast transferimi dhe kur është i pastrehë, përfiton kompensim qiraje banese deri në sigurimin e banesës nga shteti.

2. Masa dhe kriteret e kompensimit përcaktohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Neni 38

Punonjësi i Gardës, kur dërgohet për formim dhe kualifikim profesional me shkëputje nga puna mbi 6 muaj, trajtohet me pagën e gradës dhe funksionit që ka.

Neni 39

1. Punonjësi i Gardës, përveç përfitimeve që rrjedhin nga ligji nr.7709, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, gëzon të drejtën e përfitimeve të tjera suplementare.

2. Përfitimet suplementare për punonjësit e Gardës janë:

pagesë për paaftësi të përkohshme dhe të përhershme në punë;

kompensim për dëmtime trupore dhe materiale;

mbulimi i shpenzimeve për rehabilitimin shëndetësor;

ç) trajtim shëndetësor pa pagesë;

përballimi i shpenzimeve të varrimit dhe ndihmat e menjëhershme;

dh) pension të pjesshëm për vjetërsi shërbimi;

reduktim të moshës së daljes në pension pleqërie;

ë) shtesë pensioni pleqërie, invaliditeti e familjar;

f) trajtim me pagesë kalimtare, për shkak të ndërprerjes ose të pamundësisë së vazhdimit të karrierës;

g) kompensime e trajtime të tjera, të parashikuara me akte normative të veçanta.

3. E drejta e përfitimeve suplementare për punonjësit e Gardës varet nga koha (vjetërsia) e shërbimit, paga e realizuar dhe kontributi i paguar.

4. Kohë (vjetërsi) shërbimi për punonjësit e Gardës quhet:

- koha nga data e pranimit si kursant ose student;
- b) koha e njohur si ushtarak i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose si efektiv i Policisë së Shtetit;
- c) koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të një vendimi të padrejtë;
- ç) koha e qëndrimit në dispozicion, për shkak të pritjes për sistemimin në një funksion në përputhje me gradën;
- d) gjysma e periudhës së kaluar si punonjës në sektorët civilë dhe periudha e plotë e kaluar si ushtarak, para pranimit si punonjës i Gardës.
5. Paga e realizuar, për efekt të përfitimit nga ky ligj, është paga bazë mujore, së bashku me shtesat me karakter të përheshëm që ka përfituar punonjësi i Gardës.

Neni 40

Punonjësi i Gardës, në rast paaftësie shëndetësore për të shërbyer në Gardë ose kur i shkurtohet funksioni organik, ka përparësi punësimi në administratën publike, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”.

Neni 41

Garda e Republikës ndërton, me fonde shtetërore, apartamente banimi, ku strehohen punonjësit e saj. Apartamentet i marrin me qira, me kushte lehtësuese, sipas udhëzimit të Ministrit të Rendit Publik.

Neni 42

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda gjashtë muajve të nxjerrë aktet nënligjore në bazë e për zbatim të këtij ligji sipas neni 4 shkronja “ç”, neni 5 pika 2, neni 7, neni 8 pika 2, neni 14 pika 3, neni 17 pika 1, neni 18 pika 1, neni 20, neni 26, neni 33, neni 34 pika 5, neni 35, neni 36, neni 37 pika 2 dhe neni 39.

2. Ngarkohet Ministri i Rendit Publik të nxjerrë aktet sipas neni 17 pika 2, neni 18 pika 2 dhe neni 24 pika 2.

Neni 43

Ligji nr.7602, datë 9.9.1992 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me të gjitha ndryshimet e bëra në të, si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 44

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

L I G J
Nr.9070, datë 22.5.2003

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7512, DATË 10.8.1991 "PËR SANKSIONIMIN DHE MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE, TË NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE TË PAVARURA DHE PRIVATIZIMIT", I NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7653, DATË 23.12.1992; NR.7723, DATË 21.6.1993; NR.7925, DATË 19.4.1995; NR.8159, DATË 7.11.1996; NR.8306, DATË 14.3.1998 DHE NR.8333, DATË 23.4.1998

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", i ndryshuar me ligjet nr.7653, datë 23.12.1992; nr.7723, datë 21.6.1993; nr.7925, datë 19.4.1995; nr.8159, datë 7.11.1996; nr.8306, datë 14.3.1998 dhe nr.8333, datë 23.4.1998, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 25

Agjencia Kombëtare e Privatizimit është institucion qendror në varësi të Ministrit të Financave.

Agjencia Kombëtare e Privatizimit është person juridik.

Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit emërohet dhe lirohet nga Ministri i Financave.

Agjencia Kombëtare e Privatizimit është i vetmi organ që kryen procedurat e shitjes së pronës shtetërore që privatizohet, përveç rasteve kur përcaktohet shprehimisht ndryshe në ligj."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3853, datë 19.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9071, datë 22.5.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8328, DATË 16.4.1998
“PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM”

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, pas pikës 7 të nenit 43 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim të formës së prerë, përfshirë edhe institucionet për të sëmurët dhe të paaftët, mund të vizitohen pa autorizim në çdo kohë nga Avokati i Popullit ose komisionerët të pajisur me autorizim prej tij.

Avokati i Popullit ka të drejtë të takojë dhe të bisedojë në konfidencë me çdo të dënuar që i është ankuar atij, si dhe të bëjë inspektime me nismën e tij për të kontrolluar respektimin e të drejtave të të burgosurve.

Korrespondenca e të dënuarve me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3844, datë 18.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9072, datë 22.5.2003

PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i kushteve për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve, sipas parametrave standarde. Kjo sigurohet nëpërmjet funksionimit eficient të tregut të energjisë elektrike dhe zhvillimit të konkurrencës në këtë sektor, duke pasur parasysh mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, minimizimin e kostove të shërbimit me energji elektrike dhe përshtatshmërinë e tij me mjedisin.

Neni 2

Objekti

1. Ky ligj rregullon veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, përcakton të drejtat dhe detyrat e personave fizikë dhe juridikë, të administratës publike të përfshirë në këtë sektor, si dhe procedurat për përzgjedhjen dhe zhvillimin e një modeli tregu dhe të rregullave të funksionimit të tij.

Ky ligj përcakton:

- a) autoritetin institucional të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike, që më poshtë do të quhet ERE;
- b) ristrukturimin, komercializimin dhe privatizimin përfundimtar të KESH-it dhe zhvillimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
- c) nxitjen e tregtisë rajonale të energjisë elektrike;
- ç) investime në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Ministër përgjegjës për energjinë” është Ministri i Industrisë dhe Energjetikës ose ministri përgjegjës për energjinë.
2. “KESH” është Korporata Elektroenergjetike Shqiptare.
3. “Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike” është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas këtij ligji.
4. “Bordi i Komisionerëve” ose “Bordi” është organi vendimmarrës i ERE-së, i përbërë nga pesë anëtarë të emëruar, sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj.
5. “Anëtar” është një anëtar i Bordit të ERE-së, i emëruar ose që shërben në përputhje me këtë ligj, përfshirë Kryetarin e ERE-së, me përjashtim të rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.
6. “Kryetari” është Kryetari i ERE-së i emëruar ose që shërben sipas këtij ligji.
7. “Person” është një person fizik ose juridik.
8. “Licencë” është autorizimi që i jepet një personi, sipas përcaktimeve në Pjesën e Tretë të këtij ligji.
9. “I licencuar” është një person që ka licencën, sipas përcaktimeve në Pjesën e Tretë të këtij ligji.
10. “Pagesa e licencës” është pagesa e vendosur nga ERE-ja për çdo licencë të dhënë, për të kryer një veprimtari në sektorin e energjisë elektrike.
11. “Pagesa të rregullimit” janë pagesat vjetore të vendosura nga ERE-ja për veprimtaritë e licencuara, që janë objekt i rregullimit.
12. “Sistemi elektroenergjetik” është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralet e prodhimit të energjisë elektrike, linjat, nënstacionet dhe pajisjet shpërndarëse, për transmetimin dhe

shpërndarjen e energjisë elektrike te konsumatorët.

13. “Prodhim i energjisë elektrike” është prodhimi i energjisë elektrike nëpërmjet transformimit të burimeve të ndryshme energjetike nga një shoqëri prodhimi.

14. “Shoqëri prodhuese” është një person i licencuar për të kryer veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

15. “Prodhues i pavarur” është prodhuesi që nuk kryen funksionet e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik.

16. “Prodhues i privilegjuar” është prodhuesi që përmbush kriteret e parashikuara në nenin 39 dhe që përfiton një status të privilegjuar.

17. “Vetëprodhues” është personi që prodhon energji elektrike, kryesisht për përdorim vetjak.

18. “Burim zëvendësues” është një burim i dytë i furnizimit me energji elektrike, i palidhur me sistemin elektroenergjetik.

19. “Bashkëprodhim” është prodhimi i kombinuar i energjive të dobishme elektrike dhe termike, i cili siguron një kursim të konsiderueshëm të energjisë, krahasuar me prodhimin e ndarë.

20. “Transmetim” është transporti i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksioni i të cilit përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.

21. “Sistem transmetimi” është sistem linjash, strukturash mbështetëse dhe pajisjesh transformuese e kontrolluese, të përdorura për transmetimin e energjisë elektrike.

22. “Shoqëri transmetimi” ose “Operatori i sistemit të transmetimit” është person i licencuar për të kryer veprimtaritë e transmetimit të energjisë elektrike dhe të dispeçerimit.

23. “Dispeçerim” është axhustimi ose rregullimi i prodhimit të energjisë elektrike, sipas kërkesave të konsumit në nivel kombëtar.

24. “Kodi i Funksionimit të Rrjetit” është tërësia e rregullave teknike që rregullojnë funksionimin e sistemit të transmetimit.

25. “Shpërndarje” është transporti i energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke pasur parasysh shpërndarjen te konsumatori i fundit.

26. “Shoqëri shpërndarjeje” është person i licencuar për të kryer shpërndarjen e energjisë elektrike në një zonë të caktuar.

27. “Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes” është tërësia e rregullave teknike, që rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes dhe që vendosin kushtet dhe termat e shërbimit të shoqërive të shpërndarjes për konsumatorët.

28. “Parametra standardë” janë vlerat e nivelit të tensionit dhe të frekuencës së energjisë elektrike të furnizuar për konsumatorët, të përcaktuara në rregulloret e shfrytëzimit të sistemit elektroenergjetik të miratuara nga ERE-ja.

29. “Hyrja e palëve të treta” është e drejta e ligjshme e klientëve të kualifikuar dhe e furnizuesve për të përdorur rrjetet e transmetimit e të shpërndarjes.

30. “Furnizim” është çuarja dhe/ose shitja e energjisë elektrike klientit.

31. “Furnizues i kualifikuar” është personi i licencuar për të furnizuar një ose më shumë klientë të kualifikuar.

32. “Klient i kualifikuar” është klienti që ka të drejtë të zgjedhë, për nevojat e tij vetjake, furnizuesin e energjisë elektrike.

33. “Klient i mandatuar ose jo i kualifikuar” është klienti i ndryshëm nga ai i kualifikuar, i cili furnizohet nga shoqëria shpërndarëse, e pajisur me licencë për territorin ku ndodhet vendi i konsumit të energjisë elektrike.

34. “Klient i fundit” është klienti që blen energji elektrike për përdorim vetjak.

35. “Treg i energjisë elektrike” është shkëmbimi i kërkesave dhe ofertave për blerje dhe shitje ose furnizim të energjisë elektrike.

36. “Rregullat e tregut” janë rregullat e veprimit dhe menaxhimit të tregut, si dhe të marrëdhënieve tregtare ndërmjet mbajtësve të licencës.

37. “Linjë e drejtpërdrejtë” është linja e energjisë elektrike, që nuk është e lidhur me rrjetin elektroenergjetik, që lidh prodhimin me një klient të fundit.

38. “Central i vogël i energjisë elektrike” është centrali me një kapacitet më të vogël se 5 MW.

39. “Burime të energjive të rinovueshme” janë burimet e energjisë, të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo diellore, e erës, hidrike, gjeotermale, e biomasës ose biogazit, si dhe energjia nga mbetjet urbane.

40. “Forcë madhore” është një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të të licencuarit dhe nuk ndodhin për faj të tij dhe i licencuari nuk është në gjendje t’i eliminojë ato, edhe pse ka ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij.

PJESA E DYTË STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 4

1. ERE-ja është person juridik, publik me seli në Tiranë.
2. ERE-ja përbëhet nga Bordi i Komisionerëve dhe personeli teknik.
3. Bordi përbëhet nga Kryetari dhe katër anëtarë, që emërohen nga Kuvendi, me propozimin e Ekspertit Përzgjedhës, sipas pikës 5 të këtij neni.
4. Eksperti Përzgjedhës përbëhet nga dy përfaqësues të Kuvendit, përkatësisht nga Kryetari i Komisionit të Përhershëm të Industrisë, Punëve Publike dhe Tregtisë dhe Kryetari i Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, si dhe ministri përgjegjës për energjinë.
5. Eksperti Përzgjedhës:
 - a) mblidhet kur është e nevojshme ose jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të një anëtari të Bordit;
 - b) propozon dy kandidatë, për çdo vend vakant në Bord, që kanë aftësinë dhe përvojën, siç përcaktohet në pikën 7 të këtij neni.
6. Kur posti i Kryetarit të Bordit mbetet vakant, detyrat e tij kryen anëtari më i vjetër i Bordit, deri në emërimin e kryetarit të ri. Vjetërsia e tij llogaritet nga data kur është emëruar anëtar i Bordit.
7. Anëtarët e Bordit janë persona të kualifikuar dhe me përvojë, si më poshtë:
 - a) Kryetari është një person i shquar në fushën e energjetikës. Ai duhet të ketë jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet përvojë pune në administratën shtetërore, në sistemin juridik, në sektorin e energjisë elektrike ose në një biznes të rëndësishëm;
 - b) dy nga anëtarët duhet të kenë jo më pak se dhjetë vjet përvojë pune si inxhinierë në prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike;
 - c) dy anëtarë duhet të kenë kualifikim profesional dhe jo më pak se pesë vjet përvojë pune në ekonomi, tregti, kontabilitet, financë, drejtësi, në administratën gjyqësore ose publike.
8. Anëtarësia në Bordin e ERE-së do të jetë për një periudhë pesëvjeçare, përveç ERE-së së parë të emëruar sipas këtij ligji, e cila do t’i nënshtrohet rinovimit të pjesshëm nëpërmjet hedhjes me short. Dy prej anëtarëve zëvendësohen pas katër vjetësh qëndrimi në detyrë dhe dy të tjerët zëvendësohen pas tre vjetësh. Kryetari zëvendësohet pas pesë vjetësh. Shorti organizohet nga Kryetari në prezencën e të gjithë anëtarëve, sipas një rregulloreje të miratuar më parë.
9. Kur anëtari emërohet në një vend vakant, të krijuar para përfundimit të afatit kohor, për të cilin ishte emëruar paraardhësi, ai qëndron në detyrë vetëm për periudhën e mbetur të këtij mandati.
10. Anëtari i ERE-së emërohet në Bord për një mandat pesëvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.
11. Kuvendi cakton pagën e Kryetarit dhe të anëtarëve të Bordit.

Neni 5
Lirimi nga detyra i anëtarëve të Bordit të ERE-së

Anëtari i Bordit lirohet nga detyra vetëm në rastet kur:

- a) i është kufizuar ose hequr zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- b) është i paaftë për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e ERE-së për një periudhë mbi gjashtë muaj;
- c) vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
- ç) bëhet ose kandidon për deputet, bëhet nëpunës në administratën shtetërore ose në ndonjë autoritet vendor;
- d) dënohet për kryerjen e një vepre penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Neni 6
Konfliktet e interesave

1. Anëtari i Bordit ose i personelit teknik nuk mund të jetë:
 - a) pronar, aksioner i aseteve në pronësi të ndonjë të licencuari;
 - b) punonjës ose kontraktues i ndonjë të licencuari;
 - c) anëtar i bordeve ose bordeve mbikëqyrëse ose i organizmave të tjerë drejtues të ndonjë të licencuari;
 - ç) drejtor, president ose menaxher i ndonjë të licencuari, si dhe nuk lejohet të ketë interes material ose interes tjetër në fushën e energjisë.
2. Kur anëtari i Bordit ose i personelit teknik gjendet në konflikt interesi gjatë procedurave të aplikimit për licencë, ai nuk merr pjesë në shqyrtimin e aplikimit.
3. Anëtari i Bordit ose i personelit teknik mund të jetë klient i ndonjë të licencuari, por i licencuari nuk i ofron dhe anëtari i Bordit ose i personelit teknik nuk duhet të pranojë shërbim më të favorshëm ose të ndryshëm nga pikëpamja e tarifave dhe kushteve që zbatohen për publikun.
4. Për një periudhë njëvjeçare pas largimit nga detyra, anëtari i Bordit nuk ka të drejtë të punësohet ose të kompensohet në ndonjë mënyrë nga ndonjë shoqëri që ka qenë ose ka aplikuar për licencë, gjatë kohës që ai ka qenë anëtar i Bordit, pa miratimin paraprak të Këshillit të Ministrave.

Neni 7
Kryetari i ERE-së

1. Kryetari i ERE-së është administratori ekzekutiv i ERE-së dhe është përgjegjës për administrimin e ERE-së, për drejtimin e mbledhjeve të Bordit dhe për publikimin e vendimeve të tij.
2. Në mungesë të tij, Kryetari cakton njërin nga anëtarët e Bordit për të ushtruar të drejtat dhe detyrat e tij.

Neni 8
Përgjegjësitë e ERE-së

1. ERE-ja e ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me këtë ligj.
2. ERE-ja ka përgjegjësitë e mëposhtme:
 - a) përcakton rregullat dhe kërkesat për dhënie, ndryshimin dhe revokimin e licencave të shoqërive për prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, eksportin dhe importin e energjisë elektrike;
 - b) përcakton dhe rregullon tarifat e shitjes me shumicë dhe me pakicë, afatet dhe kushtet e shërbimit të energjisë elektrike, të propozuara nga i licencuari ose i rishikon ato në përputhje me rrethanat;
 - c) garanton që programet e investimeve dhe kontratat e blerjeve të energjisë elektrike të jenë në përputhje me parimet e planifikimit me koston më të ulët;
 - ç) mbron interesat e konsumatorëve të energjisë elektrike për tarifën, duke garantuar që:

- i) këto tarifa janë në përputhje me parimet e vendosjes së tarifave;
- ii) kushtet e tjera të shërbimeve, si cilësia, eficienta, qëndrueshmëria dhe siguria e furnizimit me energji elektrike janë të përshtatshme, sipas rrethanave;
- d) zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet të licencuarve dhe konsumatorëve dhe ndërmjet të licencuarve;
- dh) ruan ekuilibrin ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit, investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në sektorin e energjisë elektrike;
- e) nxit eficientën e energjisë elektrike dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në sektorin e energjisë elektrike;
- ë) nxit konkurrencën në sektorin e energjisë elektrike;
- f) monitoron dhe kontrollon shërbimet e të licencuarit, në mbështetje të autoritetit që gëzon për inspektimet, marrjen e dokumentacionit dhe të të dhënave;
- g) kontrollon nëse i licencuari, që ofron shërbimin me energji elektrike për konsumatorët, respekton kushtet e kontratës ose siguron shërbime, sipas standardeve të vendosura në licencë ose në ndonjë rregullore të miratuar nga ERE-ja;
- gj) bashkëpunon me autoritetet simotra të vendeve të tjera ose organizatat ndërkombëtare dhe merr pjesë në veprimtaritë që organizojnë ato;
- h) boton dhe bën të njohura kushtet në të cilat sigurohen shërbimet e energjisë elektrike për një transparencë maksimale, për nxitjen e konkurrencës në furnizim;
- i) miraton Kodin e Funkcionimit të Rrjetit të Transmetimit, Kodin e Funkcionimit të Shpërndarjes, si dhe kodet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e të licencuarve dhe marrëdhëniet e tyre me klientët;
- j) miraton për të licencuarit rregulloren teknike të punës për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike;
- k) miraton rregullat e praktikës dhe procedurave që do të përdoren për funksionimin e ERE-së, sipas këtij ligji.

Neni 9

Mbledhjet dhe vendimet e Bordit të ERE-së

1. Mbledhjet vendimmarrëse dhe seancat e dëgjimit të Bordit të ERE-së janë të hapura. Në raste të veçanta, Bordi mund të zhvillojë edhe mbledhje të mbyllura.
2. Numri i anëtarëve për të arritur shumicën e nevojshme në një mbledhje vendimmarrëse të Bordit është jo më pak se tre anëtarë. Bordi merr vendime me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij. Çdo anëtar, përfshirë edhe Kryetarin, ka të drejtën e një vote. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e Kryetarit është përcaktuese.
3. Bordi i merr të gjitha vendimet në mënyrë të pavarur.
4. Kundër vendimit të Bordit të ERE-së mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata gjykon vetëm mbi ligjshmërinë ose themelësinë e vendimit të Bordit dhe mund të vendosë anulimin pjesërisht ose tërësisht të vendimit, kur nuk e gjen të bazuar në ligj.
5. Në rast anulimi, Bordi rishikon vendimin e tij ose ankimon vendimin e gjykatës, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.
6. Vendimet e Bordit, përveç atyre që kanë të bëjnë me çështje të brendshme të ERE-së, botohen në Fletoren Zyrtare.

Neni 10

Raportimi

1. ERE-ja i paraqet Kuvendit të Shqipërisë, jo më vonë se fundi i tremujorit të parë të çdo viti, një raport vjetor për gjendjen e sektorit të energjisë elektrike, të veprimtarive të ERE-së, përfshirë edhe veprimtaritë financiare. Raporti bëhet publik.
2. Auditimi i veprimtarive fiskale të ERE-së kryhet nga auditues financiarë të pavarur, në

përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Me kërkesën e ministrit përgjegjës për energjinë, ERE-ja jep të dhëna, në përputhje me funksionin dhe ekspertizën e saj.

Neni 11

Personeli teknik dhe këshilltarët

1. Në kryerjen e detyrave të tij, Bordi ndihmohet nga një personel teknik, i cili përzgjidhet, emërohet dhe promovohet në detyrë, sipas kriterëve dhe procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

2. Bordi ka përgjegjësi të përcaktojë organizimin, detyrat dhe pagat e personelit teknik, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Përveç personelit teknik, Bordi, kur është e nevojshme, punëson specialistë ose këshilltarë për të ndihmuar ERE-në në kryerjen e detyrave të saj.

Neni 12

Financimi

1. Burimet e financimit të ERE-së përbëhen nga pagesat e rregullimit, të vendosura nga ajo vetë për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, dhe nga pagesat e licencave.

2. ERE-ja mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

3. ERE-ja përcakton për çdo të licencuar një pagesë rregullimi.

4. ERE-ja, pasi përcakton pagesat e rregullimit, njofton të licencuarin për shumën e detyrimit që duhet paguar. Në rast se i licencuari nuk arrin të paguajë këtë shumë brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 64 të këtij ligji.

5. Pagesat e rregullimit depozitohen në një llogari të veçantë për përdorim nga ERE-ja, të hapur në një nga bankat e licencuara, sipas legjislacionit shqiptar. Çdo fond në llogarinë e ERE-së, që nuk është përdorur gjatë një viti kalendarik, bartet në vitin pasardhës, duke reduktuar proporcionalisht pagesat e rregullimit të vitit pasardhës.

6. ERE-ja ka të drejtë të marrë hua për rastet kur shpenzimet kapitale ose operative nuk mbulohen nga pagesat e mbledhura të rregullimit. ERE-ja shlyen huatë, përfshirë dhe interesin, nga pagesat e ardhshme të rregullimit.

PJESA E TRETË

LICENCAT DHE PROCEDURAT E LICENCIMIT

Neni 13

Veprimtaritë e licencuara dhe përjashtimet

1. ERE-ja lëshon licencë për veprimtaritë e mëposhtme:

a) ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike nga ana e tyre;

b) transmetimin e energjisë elektrike;

c) shpërndarjen e energjisë elektrike;

ç) furnizimin ose tregtimin e energjisë elektrike në çfarëdo forme;

d) eksportin e energjisë elektrike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

dh) importin e energjisë elektrike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Forma, mënyra dhe pagesa e aplikimit përcaktohen nga ERE-ja.

2. ERE-ja i jep licencë për transmetimin e energjisë elektrike vetëm një personi juridik shtetëror.

3. ERE-ja i jep licencë për shpërndarjen e energjisë elektrike vetëm një personi për një zonë të caktuar shërbimi.

4. Personi që kryen veprimtari të ndryshme, të cilat janë objekt licencimi, merr licenca të veçanta për to. ERE-ja është e detyruar të shmangë çdo mospërputhje në kushtet e licencave të lëshuara, për të njëjtin person, për veprimtari të ndryshme.

5. Bashkitë dhe komunat mund të ushtrojnë veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, kur ato kanë marrë licencë nga ERE-ja.

6. Për një linjë të drejtpërdrejtë nuk kërkohet licencë transmetimi ose shpërndarjeje.

7. Vetëprodhuesi, që nuk është lidhur me sistemin elektroenergjetik, nuk mund të kërkojë licencë prodhimi.

Neni 14

Procedurat e licencimit

1. Licencat jepen nga ERE-ja, sipas procedurave që sigurojnë trajtim të barabartë, jodiskriminues dhe me transparencë gjatë procesit të licencimit. Këto procedura ndiqen sipas kërkesës për çdo tip aplikimi për licencë.

2. ERE-ja miraton rregulloren për procedurat e licencimit në përputhje me këtë ligj, ku përcaktohen kriteret dhe kushtet për dhënien, ndryshimin ose heqjen e licencës, si dhe pagesa që duhet kryer për çdo tip aplikimi për licencë. ERE-ja autorizohet të miratojë rregulloren për të vendosur procedura të thjeshta dhe të përshejtuara për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve elektrike me një kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW.

Neni 15

Kushtet e licencës

1. ERE-ja përcakton kushtet e çdo license, duke marrë parasysh:

- a) afatet e kërkuara për vlefshmërinë e licencës;
- b) vendndodhjet dhe territoret në të cilat do të kryhen veprimtaritë e licencuara të energjisë elektrike;
- c) funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të impianteve, të pajisjeve ose të rrjetit;
- ç) kërkesat për llojin e burimeve parësore të energjisë;
- d) kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare, jetën e qytetarëve, pasurinë, shëndetin dhe rendin publik;
- dh) kërkesat financiare;
- e) mbrojtjen e mjedisit;
- ë) nxitjen e efikasitetit të energjisë në sektorin e energjisë elektrike;
- f) detyrimet e shërbimit publik, siç parashikohet në këtë ligj;
- g) nxitjen e një tregu kompetitiv të energjisë elektrike dhe parimet e kostos më të ulët në furnizimin me energji elektrike;
- gj) efektin ndaj sigurisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. ERE-ja mund të kërkojë prova, të dhëna dhe dokumente, që i nevojiten për të verifikuar kualifikimet dhe kompetencat e aplikuesit për licencë.

3. ERE-ja mund t'ia refuzojë dhënien e licencës një aplikuesi kur ky nuk përmbush njërin nga kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Kur ERE-ja arrin në përfundimin se ndonjë nga kushtet e paplotësuara nuk është thelbësore dhe mund të plotësohet, ajo mund t'ia japë licencën, me kusht që i licencuari të përmbushë kushtet e paplotësuara brenda një afati kohor të përcaktuar nga ERE-ja.

Neni 16

Njoftimi i aplikimeve dhe vërejtjeve për licencën

1. Për çdo aplikim për licencë, sipas këtij neni, ERE-ja boton, brenda 14 ditëve pasi është bërë aplikimi, njoftimin e kërkesës për licencë, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren për

procedurat e licencimit. Për çdo aplikim për një licencë eksporti ose importi të energjisë elektrike, pas paraqitjes së aplikimit, ERE-ja i dërgon ministrit përgjegjës për energjinë njoftim me shkrim për këtë aplikim.

2. Licenca jepet pasi shqyrtohen të gjitha vërejtjet ose ankesat për këtë kërkesë. ERE-ja nuk merr parasysh vërejtjet ose ankesat e bëra pas dy muajve nga data e botimit të parë të njoftimit.

3. Kur një autoritet vendor i interesuar dërgon një vërejtje ose ankesë dhe ERE-ja i vlerëson këto të pabazuara, ajo njofton autoritetin vendor me shkrim, duke dhënë arsyet për këtë vendim.

Neni 17

Refuzimi i licencës

1. ERE-ja mund të refuzojë dhënien e licencës kur konstaton rrezik për jetën e njerëzve, shëndetin, mjedisin, pasurinë e personave të tretë dhe interesat e konsumatorëve ose dëmtimin e furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike.

2. Nuk i jepet licencë një personi:

a) i cili është në pamundësi të pagimit të debive ose të likuidimit, sipas legjislacionit për falimentimin;

b) licenca e të cilit është anuluar ose hequr dhe periudha e përcaktuar në vendimin e ERE-së për heqjen nuk ka përfunduar.

3. Në rast refuzimi, aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri për licencë për të njëjtën veprimtari, por jo më parë se gjashtë muaj pas datës efektive të vendimit të ERE-së, që refuzon dhënien e licencës mbi bazën e aplikimit të mëparshëm.

Neni 18

Heqja e licencës

1. ERE-ja mund ta heqë licencën kur i licencuari:

a) nuk përmbush kushtet e licencës së dhënë sipas këtij ligji;

b) gjatë kryerjes së veprimtarisë në sektorin e tij, shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit;

c) rrezikon shëndetin, jetën dhe pronën e njerëzve;

ç) nuk arrin të shlyejë pagesat e rregullimit të përcaktuara nga ERE-ja, sipas nenit 12;

d) nuk e ka nisur veprimtarinë e licencuar brenda kohës së përcaktuar në licencë;

dh) nuk arrin të përmbushë kushtet e licencës për shkaqe financiare.

2. Në rast se ERE-ja mendon se heqja e licencës mund të ndikojë në interesin publik, vepron sipas nenit 64 të këtij ligji.

3. ERE-ja miraton rregulloren, ku përcaktohen procedurat e heqjes së një licence. Këto procedura kërkojnë që ERE-ja:

a) të njoftojë me shkrim të licencuarin, se ka propozuar heqjen e licencës të paktën 60 ditë para se heqja të bëhet e detyrueshme, duke argumentuar arsyet për këtë heqje;

b) t'i japë mundësi të licencuarit të përgjigjet me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit;

c) kur është në interesin e përgjithshëm, mund t'i japë të licencuarit 30 ditë afat, pas përgjigjes me shkrim, që të veprojnë në përputhje me licencën, në mënyrë që të mënjanojnë shkaqet për të cilat është propozuar heqja e licencës.

4. Kur ERE-ja heq një licencë, duhet të zbatojë njërin nga kushtet e përkohshme, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, në mënyrë që pajisjet dhe asetet, në pronësi të të licencuarit, të mund të vazhdojnë të funksionojnë në sigurimin e shërbimit të energjisë elektrike për klientët:

a) ta lejojë të licencuarin të vazhdojë t'i përdorë këto pajisje dhe asete, sipas kushteve dhe afateve të caktuara;

b) të kontraktojë me një ose me më shumë shoqëri private, që mund të ndër marrin vazhdimin e këtij shërbimi;

c) të emërojnë një administrator, që të mbikëqyrë ose të operojë pajisjet dhe pasuritë, sipas licencës.

5. Kushtet e përkohshme vendosen derisa licenca t'i jepet një personi tjetër, që do të vazhdojë këtë veprimtari.

Kur hiqet një licencë, Këshilli i Ministrave vendos shpronësimin e aseteve të të licencuarit kundrejt një kompensimi të drejtë, sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik".

Neni 19

Ndryshimet e licencës

1. Çdo i licencuar mund të kërkojë ndryshim të licencës.

2. ERE-ja mund të bëjë ndryshime të afateve dhe kushteve të licencës, të cilat i vlerëson të domosdoshme, pasi të ketë vlerësuar efektet e ndryshimit të propozuar ndaj detyrimeve të të licencuarit, sipas këtij ligji dhe licencës së tij, si dhe me kusht që ndryshimet jo vetëm të jenë kërkuar me shkrim, por edhe të jenë pranuar nga i licencuari.

3. Për ndryshimin e licencës zbatohen dispozitat e mëposhtme:

a) ERE-ja boton një njoftim të aplikimit të të licencuarit sipas formës së përcaktuar në rregulloren e procedurave të licencimit;

b) ERE-ja nuk mund të bëjë asnjë ndryshim para se të ketë marrë të gjitha vërejtjet dhe ankesat për këtë aplikim brenda dy muajve nga botimi i parë i aplikimit dhe pasi t'i ketë analizuar ato.

4. ERE-ja, para se të miratojë ndryshimin e një licence, me kërkesën e të licencuarit, boton ndryshimet e propozuara dhe analizon të gjitha vërejtjet dhe ankesat e marra për ndryshimet e propozuara brenda dy muajve nga botimi i parë i njoftimit.

Neni 20

Ndalimi i transferimit të aseteve

1. Asnjë i licencuar nuk mund të transferojë biznesin e tij ose pjesë të tij nëpërmjet shitjes, pengut, qirasë, shkëmbimit ose formave të tjera, pa miratimin me shkrim të ERE-së.

2. Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE-ja miraton një rregullore për shqyrtimin dhe miratimin e shitjes, dhënies me qira, transferimit ose ndryshimeve të tjera të çdo aseti të të licencuarit ose të pronësive të përcaktuara për prodhimin, transmetimin ose shpërndarjen, sipas nenit 3 të këtij ligji, përfshirë përjashtimet nga miratimi për asetet me vlerë minimale.

Neni 21

Sistemet e njëjta dhe të standardizuara të llogarive

Brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE-ja harton dhe miraton një sistem të njëjtë dhe të standardizuar llogarish për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, mbështetur në legjislacionin shqiptar dhe standardet e pranuar ndërkombëtare të kontabilitetit. Raportimi vjetor financiar dhe ekonomik bëhet në ERE nga të gjithë të licencuarit, sipas këtij sistemi.

Neni 22

Raportet vjetore të të licencuarit

1. Të licencuarit paraqesin në ERE, jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i vitit, bilancet e plota financiare. Në këto raporte vjetore përfshihen:

a) përmbledhjet e të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo veprimtari të veçantë të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes;

b) përmbledhjet e të ardhurave dhe shpenzimeve përkatëse për të gjitha degët e ndërmarrjes

dhe një përmbledhje të rregullave, sipas të cilave janë shpërndarë të ardhurat, asetet e shpenzuara dhe përgjegjësitë ndërmjet veprimtarive të biznesit dhe degëve;

c) materiale të tjera shtesë, që mund të kërkohen nga ERE-ja.

2. Këto bilance financiare duhet të jenë në përputhje me sistemin e njëjtë dhe standard të llogarive, pasi të jenë miratuar nga ERE-ja, sipas nenit 21 të këtij ligji.

Neni 23

Mbajtja e bilanceve të llogarive

Çdo shoqëri e licencuar në sektorin e energjisë elektrike, që kryen më shumë se një të njënj nga veprimtaritë, që ka të bëjë me prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen, mban llogari të ndara për çdo veprimtari në njësinë e vet të llogarive, si dhe përgatit bilance llogarish të konsoliduara, në përputhje me praktikatat e kërkuara të llogarive. Këto shoqëri mbajnë, gjithashtu, llogari të ndara për veprimtaritë që nuk lidhen me ato të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Neni 24

Programet e investimeve dhe marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike

1. Brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, çdo i licencuar është i detyruar të paraqesë në ERE programet e veta të investimeve për vitin pasardhës. Marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike, të lidhura nga një i licencuar me një furnizues të energjisë elektrike, duhet të jenë në përputhje me kushtet dhe standardet e përgjithshme, të kërkuara nga rregulloret e zbatueshme, të miratuara nga ERE-ja.

2. Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE-ja harton dhe miraton një rregullore për procedurat e paraqitjes së programeve të investimit të të licencuarve, në të cilat përshkruhen kushtet dhe standardet e përgjithshme për marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike.

3. Një program investimi ose një marrëveshje e blerjes së energjisë elektrike duhet të marrë parasysh strategjinë kombëtare për sektorin e energjisë elektrike, të hartuar nga Këshilli i Ministrave, parimet e planifikimit me koston më të ulët dhe ndryshueshmërinë e burimeve gjeneruese.

Neni 25

Detyrimet e shërbimit publik

1. Veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit me energji elektrike të klientëve të mandatuar tariforë, organizimi i tregut të energjisë elektrike dhe funksionimi i sistemit elektroenergjetik realizohen si shërbime publike.

2. Gjatë zbatimit të shërbimeve publike ndaj të licencuarve, ERE-ja merr parasysh detyrimet lidhur me:

a) sigurinë e furnizimit;

b) rregullsinë, cilësinë dhe çmimin e furnizimit;

c) përdorimin e burimeve vendase të energjisë;

ç) përdorimin e frytshëm të lëndëve djegëse dhe energjisë;

d) mbrojtjen e mjedisit;

dh) mbrojtjen e shëndetit, jetës dhe pronës së njerëzve.

3. I licencuari nuk ka si detyrim të shërbimit publik për të siguruar shërbim në një zonë ku nuk ofrohet ky shërbim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç rastit kur kërkohet nga rregulloret e miratuara nga ERE-ja. Këto rregullore parashikojnë një ndarje të drejtë të kostove shtesë për të siguruar këtë shërbim, ndërmjet klientëve që kërkojnë shërbimin dhe klientëve ekzistues të të licencuarit.

4. Kostot e realizuara nga çdo i licencuar, sipas detyrimeve të shërbimit publik, janë në përputhje me nenet 27 dhe 28 të këtij ligji.

PJESA E KATËRT
TARIFAT E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 26

Autoriteti i ERE-së për vendosjen e tarifave

1. ERE-ja është institucioni përgjegjës për vendosjen e tarifave për të gjitha veprimtaritë që kryhen nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

2. Brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ERE-ja harton dhe miraton një rregullore për procedurat dhe standardet, sipas të cilave ajo miraton, ndryshon ose refuzon tarifatat, afatet dhe kushtet e shërbimeve të energjisë elektrike.

Neni 27

Parimet e vendosjes së tarifave

1. Tarifatat për shërbimet e energjisë elektrike, të vendosura nga ERE-ja, kanë për qëllim:

a) të mbrojnë konsumatorët nga çmimet monopol;
b) t'u sigurojnë të licencuarve mundësi për të shlyer kostot e shërbimit;
c) të nxisin efikasitetin në veprimet e brendshme dhe praktikatat e menaxhimit, duke lejuar rritjen e shlyerjes financiare të të licencuarit, si rezultat i minimizimit të kostove të shërbimit, duke përmbushur të gjitha kërkesat e licencës për vazhdueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit;

ç) të nxisin efikasitetin ekonomike brenda sektorit të energjisë elektrike, duke reflektuar kostot marxhinale afatshkurtra dhe afatgjata dhe duke u dhënë të licencuarve sinjale të kujdesshme çmimesh;

d) marrjen parasysh të politikës së Këshillit të Ministrave për konsumatorët parësorë të furnizimit me energji elektrike, me kusht që të mos pengojë të licencuarin të shkëpusë çdo person juridik ose fizik, për shkak të mospagimit të energjisë elektrike të konsumuar, siç jepet në kontratë ose në kushtet e miratuara të shërbimit;

dh) marrjen parasysh të politikës së Këshillit të Ministrave lidhur me subvencionet e mundshme, duke ndaluar subvencionimin e çdo kategorie konsumatorësh për llogari të të licencuarit ose të çdo kategorie tjetër konsumatorësh;

e) të reflektojnë diferencat e kostove ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorëve.

2. Tarifatat janë në përputhje me parimet e njohura të përcaktimit të tarifave jodiskriminuese, të përcaktuara në mënyrë transparente dhe të bazuara në kritere objektive.

3. Kostot mbulohen nga çdo kategori konsumatorësh, në raport me kostot e shërbimit të kësaj kategorie.

4. Për çdo kategori konsumatorësh mund të vendosen tarifa të ndryshme, duke marrë parasysh stinën, ndarjen kohore, ditë ose natë, periudhën e pikut të ngarkesës, përdorimin mesatar ose të përgjithshëm ose parametra të ngjashëm me to.

Neni 28

Rregullat për vendosjen e tarifave

1. ERE-ja përcakton metodat dhe procedurat për të llogaritur shifrat ekonomike dhe financiare, për vendosjen e tarifave për çdo veprimtari në sektorin e energjisë elektrike.

2. Gjatë shqyrtimit të tarifave të paraqitura për miratim nga një i licencuar, ERE-ja merr parasysh:

a) kostot për prodhimin ose blerjen e energjisë elektrike;

b) kostot operative të mirëmbajtjes dhe riparimit, duke përfshirë shpenzimet e amortizimit;

c) kostot e mbajtjes së kapaciteteve rezervë dhe rregulluese, të kërkuara për një furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike;

ç) kostot për lëndë djegëse dhe mbajtjen e rezervave me lëndë djegëse;

- d) kostot për mbrojtjen e mjedisit;
- dh) kostot për pagat dhe shpenzime të ngjashme;
- e) taksat dhe detyrimet e tjera fiskale, të parashikuara nga legjislacioni shqiptar;
- ë) pagesat e licencës dhe të rregullimit, siç parashikohen nga ky ligj;
- f) kthimin e kapitalit të investuar, duke marrë parasysh riskun e biznesit dhe koston kapitale;
- g) kostot e përmbushjes së detyrimeve të shërbimit publik, siç parashikohen nga ky ligj;
- gj) kostot e programeve të ruajtjes së energjisë.

3. ERE-ja nuk përfshin në normat e tarifave kostot që përmbajnë shpenzime të tepërta dhe të paargumentuara, si rezultat i moseficientës së të licencuarit.

4. Rritja e tarifave nuk mund të bëhet më shumë se një herë brenda një viti financiar, përveç rasteve kur ERE-ja e lejon këtë pas paraqitjes së një arsytimi të bazuar.

Neni 29

Periudha e tranzicionit për rritjen e tarifave

Për të zbutur ndikimet sociale të rritjes së tarifave për klientët familjarë, ERE-ja mund të vendosë një periudhë tranzicioni, jo më shumë se katër vjet, për të lëvizur me rritje vjetore drejt tarifave të përcaktuara për të mbuluar kostot e të licencuarit dhe për të siguruar shërbimin me energji elektrike, sipas dispozitave të këtij ligji.

PJESA E PESTË

SISTEMI ELEKTROENERGJETIK

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 30

Përbërja e sistemit elektroenergjetik

1. Sistemi elektroenergjetik i vendit përbëhet nga centralet prodhuese, sistemi i transmetimit me pajisjet përkatëse të interkonjeksionit dhe të sistemit të komunikimit e të informacionit, rrjetet e shpërndarjes dhe pajisjet elektrike të konsumatorëve.

2. Sistemi elektroenergjetik funksionon si një sistem i integruar dhe me proces të vazhdueshëm prodhimi, transformimi, transmetimi dhe shpërndarjeje të energjisë elektrike.

Neni 31

Interkonjeksioni me sistemet e tjera elektroenergjetike

1. Sistemi elektroenergjetik i vendit lidhet me sistemet elektroenergjetike të vendeve të tjera nëpërmjet linjave të interkonjeksionit. Këto linja ndërtohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.

2. Funksionimi i sistemit elektroenergjetik, në paralel me sisteme të tjera elektroenergjetike dhe sisteme të ndërlidhura elektroenergjetike, kryhet në përputhje me marrëveshjet dy ose shumëpalëshe në fushën e elektroenergjisë, duke respektuar standardet teknike dhe kërkesat e funksionimit të sigurt, si dhe standardet e tjera të interkonjeksionit, të përcaktuara nga ERE-ja, sipas nenit 55 të këtij ligji.

Neni 32

Standardet teknike dhe të sigurisë së sistemit elektroenergjetik

1. Instalimet e prodhimit, të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, së bashku me ato të projektuara për marrjen e energjisë elektrike nga përdoruesit, si dhe elementet dhe materialet teknike për instalimet e sistemit elektroenergjetik, duhet të plotësojnë standardet teknike

dhe të sigurisë, në përputhje me aktet nënligjore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

2. Aktet nënligjore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni duhet të garantojnë:

- a) mbrojtjen e individit dhe pasurisë, që mund të dëmtohen nga instalimet;
- b) arritjen e rregullsisë së kërkuar të furnizimeve me energji elektrike;
- c) vendosjen e standardeve për të lehtësuar inspektimin e instalimeve dhe njësimin e kushteve të furnizimit;
- ç) rritjen e qëndrueshmërisë së instalimeve dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike;
- d) mbrojtjen e mjedisit, të drejtave dhe interesave të konsumatorëve;
- dh) arritjen e standardeve të kërkuara në përdorimin e energjisë elektrike.

Neni 33

Ndarja e veprimtarive

1. Çdo shoqëri elektroenergjetike, që kryen veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, detyrohet t'i ndajë llogaritë e veta financiare jo më vonë se 12 muaj nga data kur ky ligj hyn në fuqi, sipas veprimtarive të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes.

2. Çdo shoqëri që ushtron prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, që merret edhe me veprimtari të tjera joelektroenergjetike, mban regjistrime të ndara të llogarive për veprimtaritë e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike, duke shmangur diskriminimin, ndërsuvcionimin dhe shtrembërimin e konkurrencës. Ajo mban llogari të veçanta për çdo veprimtari si të ishin shoqëri të veçanta.

KREU II

PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 34

I licencuari në prodhimin e energjisë elektrike

1. Prodhimi i energjisë elektrike mund të kryhet nga një person fizik ose juridik, që ka licencën për prodhimin e energjisë elektrike, sipas dispozitave të Pjesës së Tretë të këtij ligji.

2. Veprimtaria e prodhimit përfshin edhe transformimin e energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes.

3. Dhënia e licencës së prodhimit nuk e përjashton mbajtësin e saj nga detyrimi për të marrë autorizime ose miratime të tjera, që parashikohen nga legjislati në fuqi.

4. Në rastin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet, prodhuesi duhet të marrë më parë lejen administrative, për përdorimin e ujit për qëllime publike nga institucionet përgjegjëse, siç parashikohet nga legjislati në fuqi.

Neni 35

Të drejtat dhe përgjegjësitë e prodhuesit

1. Prodhuesi ka të drejtë:

- a) të përdorë në impiantin e vet ato burime parësore energjie që përcaktohen në licencë, duke ruajtur kapacitetin prodhues, karakteristikat teknike dhe kushtet e mbrojtjes së mjedisit;
- b) të kontraktojë për shitjen e energjisë elektrike, sipas kushteve të vendosura në këtë ligj, në rregulloret e ERE-së dhe në rregullat e tregut të miratuara nga ERE-ja;
- c) të dispeçerojë energjinë elektrike, nëpërmjet operatorit të sistemit të transmetimit;
- ç) të kenë akses në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes, nëpërmjet një pagese të bazuar në tarifën e transmetimit të vendosura nga ERE-ja;
- d) të marrë pagesat që i përkasin sipas kontratës.

2. Prodhuesi është i detyruar:
- a) të zbatojë kushtet e vendosura në licencat e prodhimit;
 - b) të përmbushë kodet e zbatueshme të funksionimit të rrjetit, rregullat e tregut dhe rregulloret e tjera;
 - c) të pajiset me aparate matëse, për matjen e energjisë elektrike që kalon në rrjetin përkatës;
 - ç) të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që lidhen me shfrytëzimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike.

Neni 36

Rezervat e lëndëve djegëse ose të kapacitetit prodhues

1. Për të siguruar një furnizim të qëndrueshëm për klientët, personi që prodhon energji elektrike duhet të mbajë rezerva të veçanta lëndë djegëse ose kapacitete të veçanta rezervë prodhimi të energjisë elektrike.
2. Tipi, sasia e rezervave të lëndëve djegëse dhe kapaciteti rezervë për tipa të veçantë të centraleve prodhuese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Kostot e rezervave të lëndës djegëse dhe të kapaciteteve rezervë trajtohen si kosto operative.

Neni 37

Kostot e lidhjes me rrjetin

Kostot e lidhjes së një prodhuesi të ri, të pavarur, të energjisë ose të një vetëprodhuesi dhe kostot në rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, që lidhen me të, përballohen nga prodhuesi, në përputhje me kodin e funksionimit të rrjetit ose me kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike. Operatori i sistemit ka të drejtën e pronësisë mbi këtë lidhje.

Neni 38

Prodhuesit e privilegjuar të energjisë elektrike

1. Prodhuesi i privilegjuar i energjisë elektrike është:
 - a) prodhuesi që prodhon energji elektrike nëpërmjet përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë, kapaciteti i instaluar i të cilave është deri në 25 MW dhe, në rast të burimeve hidroelektrike të energjisë, deri në 10 MW;
 - b) prodhuesi që prodhon energji elektrike nëpërmjet skemave të bashkëprodhimit, kapaciteti i instaluar i të cilave nuk është më i madh se 100 MW;
 - c) vetëprodhuesi për tepriçën e tij të energjisë elektrike, nëse ai përdor burime të energjive të rinovueshme dhe kapaciteti i tij i instaluar nuk është më i madh se 10 MW.
2. ERE-ja ka autoritetin t'i japë statusin e prodhuesit të privilegjuar prodhuesit që plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, i cili gëzon një trajtim favorizues nga operatori i sistemit të transmetimit në dispeçerimin e energjisë elektrike të prodhuar prej tij.
3. Mënyra, shtrirja, afatet dhe kushtet sipas të cilave operatori i sistemit të transmetimit i bën trajtim favorizues prodhuesit të privilegjuar të energjisë elektrike, përcaktohen në kodin e funksionimit të rrjetit. Favorizimi nuk prek zbatimin e parimit të kostos më të ulët në veprimtarinë e prodhimit.

Neni 39

Burimet e energjive të rinovueshme

1. Prodhuesi i energjisë elektrike, me kapacitet të instaluar më të lartë se 100 MW, është i detyruar të prodhojë energji elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë për sistemin elektroenergjetik, jo më pak se 2 për qind të prodhimit të tyre të përgjithshëm të energjisë elektrike nga burime të tjera.

2. Detyrimi i mësipërm është i përmbushur nëse ata blejnë sasi të njëjta të energjisë elektrike nga prodhues të tjerë ose nga operatori i sistemit të transmetimit. Në këtë rast, detyrimi konsiderohet i përmbushur kur ERE-ja ose institucionet simotra të vendeve nga importohet energjia elektrike kanë një proces të ndërsjellë certifikimi të prodhimit, nga burimet e energjive të rinovueshme.

KREU III TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 40 **Sistemi i transmetimit**

1. Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike përbëhet nga linja dhe stacione transformuese elektrike ose çdo instalim tjetër, funksioni i të cilave përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.

2. Çdo aset që përfshin komunikimin, mbrojtjen, kontrollin, shërbimet ndihmëse, truallin, ndërtesat dhe asete të tjera ndihmëse, elektrike ose jo, të cilat nevojiten për funksionimin e duhur të instalimeve të veçanta të sistemit të transmetimit, janë elemente përbërëse të sistemit të transmetimit.

Neni 41 **Operatori i sistemit të transmetimit**

1. Sistemi i transmetimit drejtohet nga një operator i sistemit të transmetimit, i cili ka licencë për të kryer veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike.

2. Operatori i sistemit të transmetimit është përgjegjës për zhvillimin dhe zgjerimin e sistemit të transmetimit, si dhe për menaxhimin e çdo tranzitimi të energjisë elektrike, ndërmjet sistemeve të huaja, që shfrytëzojnë rrjetin shqiptar të energjisë elektrike.

3. Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike siguron:

- a) menaxhimin e integruar dhe funksionimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit;
- b) mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve të sistemit të transmetimit, në përputhje me kërkesat e sigurisë teknike dhe të funksionimit;
- c) zhvillimin e sistemit të transmetimit, në përputhje me parashikimet afatgjata dhe planet e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike;
- ç) mirëmbajtjen dhe zhvillimin e aseteve ndihmëse të transmetimit;
- d) furnizimin me energji elektrike të klientëve të lidhur drejtpërdrejt me sistemin e transmetimit.

Neni 42 **Kodi i funksionimit të rrjetit**

1. Funksionimi i sistemit të transmetimit kryhet në përputhje me dispozitat e kodit të funksionimit të rrjetit, që miratohet nga ERE-ja, sipas nenit 55 të këtij ligji.

2. Kodi i funksionimit të rrjetit rregullon:

a) kushtet për paraqitjen e një aplikimi për të drejtë hyrjeje në sistem dhe dokumentet përkatëse;

b) specifikimet minimale, teknike dhe funksionale, për të siguruar hyrjen dhe lidhjen me sistemin e transmetimit të instalimeve prodhuese, të shoqërive të shpërndarjes, të klientëve të kualifikuar, si dhe të interkonjeksionit me rrjetet e tjera;

c) afatin kohor, brenda të cilit operatori i sistemit të transmetimit është i detyruar t'i përgjigjet aplikimit të paraqitur, si dhe pasojat e mospërgjigjes brenda afatit;

ç) kriteret e zbatuara nga operatori i sistemit, për shpërndarjen nga qendra e dispeçerisë të ngarkesës në instalimet e disponueshme prodhuese, si dhe për përdorimin e interkonjeksioneve;

d) mënyrën, shtrirjen, afatet dhe kushtet në të cilat operatori i sistemit të transmetimit, kur dispeçeron instalimet e prodhimit, u jep përparësi instalimeve të prodhimit, që përdorin burime të rinovueshme të energjisë, si dhe instalimeve bashkëprodhuese;

dh) çdo hollësi tjetër, të nevojshme për rregullimin e funksionimit të sistemit të transmetimit.

3. ERE-ja miraton rregullore për të lehtësuar hyrjen në rrjet të centraleve elektrike me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW.

KREU IV SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 43

Shoqëritë e shpërndarjes së energjisë elektrike

1. Rrjetet e shpërndarjes drejtohen nga shoqëritë e licencuara, për të ndërmarrë veprimtari në fushën e shpërndarjes së energjisë elektrike në një territor të caktuar.

2. Shoqëria shpërndarëse siguron nga rrjeti i saj i shpërndarjes për zonat që mbulohen:

a) furnizimin dhe shitjen e energjisë elektrike te klientët e lidhur me rrjetin e shpërndarjes, me përjashtim të klientëve të kualifikuar;

b) menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes;

c) mirëmbajtjen e mjediseve dhe pajisjeve, në përputhje me kërkesat teknike;

ç) zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe të ndryshimit të kërkesës në rajon ose në territor;

d) shërbime të tjera për klientët, të nevojshme për të përmbushur detyrimet e tyre, sipas këtij neni.

Neni 44

Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes

1. Funksionimi i rrjetit të shpërndarjes kryhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Funksionimit të Shpërndarjes, që miratohet nga ERE-ja.

2. Për hartimin dhe miratimin e Kodit të Funksionimit të Shpërndarjes, ERE-ja bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë.

3. Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes përcakton afatet standarde dhe kushtet e shërbimit, përfshirë kontratën e përgjithshme të shoqërisë, ndërmjet një klienti dhe shoqërisë shpërndarëse, si dhe rrethanat në të cilat disa afate dhe kushte mund të trajtohen nga kontrata të veçanta, ndërmjet klientëve dhe shoqërisë së shpërndarjes.

4. Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes miratohet nga ERE-ja jo më vonë se data 31 dhjetor 2003.

KREU V FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE

Neni 45

Veprimtaritë e furnizimit me energji elektrike

1. Furnizimi i përdoruesve me energji elektrike kryhet nga shoqëritë përkatëse të shpërndarjes, në rastin e klientëve të mandatuar tariforë dhe nga një furnizues kompetitiv i kualifikuar, i licencuar nga ERE-ja, në rastin e klientëve me statusin e klientit të kualifikuar.

2. Çdo furnizues kompetitiv i kualifikuar mund të aplikojë dhe të marrë licencë furnizimi për t'u shërbyer klientëve të kualifikuar të veçantë pas miratimit të rregullave të tregut, në përputhje me nenin 54 të këtij ligji.

3. Licenca e furnizimit nuk jepet mbi baza monopoli dhe me të drejta ekskluzive.

Neni 46

Të drejtat dhe detyrimet e furnizuesve

Furnizuesi ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:

- a) zbaton kushtet e licencës së furnizimit;
- b) plotëson kërkesën e klientëve për energji elektrike, në përputhje me kushtet e kontratës së shoqërisë;
- c) merr pagesat që i takojnë sipas kontratave;
- ç) blen energjinë elektrike, që i nevojitet për të furnizuar klientët;
- d) ka të drejtë hyrjeje në rrjet, siç përcaktohet nga ky ligj dhe nga rregulloret e tjera të zbatueshme, të miratuara nga ERE-ja;
- dh) mat furnizimet me energji elektrike, duke siguruar saktësinë e matjes dhe të drejtën e aksesit në aparatet matëse;
- e) përmbush të gjitha detyrimet e tjera, që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji dhe legjislacioni ose rregulloret përkatëse në fuqi.

Neni 47

Gjendja emergjente në furnizimin me energji elektrike

1. Këshilli i Ministrave shpall gjendjen emergjente në furnizimin me energji elektrike në rastet:

- a) e një force madhore;
- b) kur autoritetet qeveritare marrin masa për të siguruar mbrojtjen, në një gjendje gatishmërie;
- c) kur ndodhin aksidente në pajisjet e prodhimit, të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- ç) kur ka mungesa afatgjata të burimeve energjetike, të rëndësishme për prodhimin e energjisë elektrike.

2. Gjatë gjendjes së emergjencës, i licencuari dhe klienti duhet t'u përmbahen kufizimeve në përdorimin e energjisë elektrike. Ministri përgjegjës për energjinë, nëpërmjet një rregulloreje të veçantë, përcakton zgjatjen dhe mënyrën e kufizimit të furnizimit me energji elektrike.

3. Të licencuarit ose furnizuesit e tjerë nuk përgjigjen ligjërisht për kompensimin e dëmeve të shkaktuara, si rezultat i kufizimit ose ndërprerjes së energjisë elektrike në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përveç gjendjes së emergjencës të ndodhur si rezultat i gabimeve të të licencuarit ose të furnizuesit.

Neni 48

Klienti i kualifikuar

1. Pas miratimit të rregullave të tregut të energjisë elektrike nga ERE-ja, klienti me një konsum vjetor mbi 100 GWh për vend konsumi, mund të aplikojë në ERE për të marrë statusin e klientit të kualifikuar. Pas marrjes së këtij statusi, ai mund të lidhë kontratë për blerjen e energjisë elektrike nga çdo furnizues i kualifikuar, vendas ose i huaj, i licencuar, i zgjedhur prej tij. Kontrata në këtë rast duhet të jetë në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara nga ERE-ja.

2. Niveli i konsumit vjetor, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, për të marrë statusin e klientit të kualifikuar, mund të ulet me kohë, në varësi të hapjes së tregut të energjisë elektrike.

Neni 49

Linja e drejtpërdrejtë

Prodhuesi i energjisë elektrike, që dëshiron të përfundojë një kontratë me një klient të kualifikuar, pas miratimit të rregullave të tregut të energjisë elektrike dhe me lejen paraprake të

ERE-së, kur nuk ka mundësi hyrjeje në rrjet, mund të ndërtojë një linjë të drejtpërdrejtë, në përputhje me rregullat e ERE-së.

Neni 50 **Burimi zëvendësues**

1. Furnizuesi përcakton kushtet teknike të instalimit të burimit zëvendësues, pronë e klientit, për furnizimin me energji elektrike të objekteve të tij, si dhe kushtet që duhet të plotësohen nga ky burim zëvendësues për të mos sjellë shqetësime në rrjetin e furnizuesit. Kushtet janë të detyrueshme për klientët.

2. Klienti që kërkon të instalojë burim zëvendësues, i bën furnizuesit një kërkesë me shkrim dhe siguron akses për përfaqësuesit e furnizuesit, për inspektime të burimit zëvendësues.

3. Furnizuesi ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me energji elektrike për një klient, në rast se ky i fundit nuk i përmbush detyrimet, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 51 **Matja e energjisë elektrike të furnizuar**

1. Energjia elektrike, e përdorur nga klienti, matet dhe faturohet nga furnizuesi, sipas regjistrimeve të aparateve matëse. Instalimi, mirëmbajtja dhe verifikimi i saktësisë së matësit bëhen nga furnizuesi me shpenzimet e veta. ERE-ja është e autorizuar t'i kërkojë furnizuesit të kryejë kontrollet e aparateve matëse për çdo kategori klientësh.

2. Kur klienti dyshon në saktësinë e një matësi ose kur ka vënë re pasaktësi në matës, bën kërkesë me shkrim tek ERE-ja, e cila urdhëron furnizuesin të kontrollojë matësin. Kur pas kontrollit vërehen pasaktësi në matës, shpenzimet për riparimin ose zëvendësimin e tij janë në ngarkim të furnizuesit. Kur nuk vihet re ndonjë pasaktësi, shpenzimet e kontrollit paguhen nga klienti.

3. Çdo ndërhyrje tjetër në matësit e furnizuesit është e ndaluar dhe ndëshkohet, sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 52 **Klientët pa matës**

1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë aparat matës për çdo klient të lidhur me rrjetin.

2. Për klientët, që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk janë të pajisur me aparat matës, për një periudhë tranzitore, furnizuesi i propozon për miratim ERE-së një përdorim të përllogaritur aforfë për këtë kategori klientësh, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga ERE-ja. Klienti, që nuk ka aparat matës, paguan në përputhje me këtë përllogaritje.

3. Periudha tranzitore e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni është deri në datën 31 dhjetor 2004.

PJESA E GJASHTË TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 53 **Zgjedhja e tregut**

1. Brenda datës 31 dhjetor 2003, ERE-ja, në bashkëpunim me gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë, i propozon Këshillit të Ministrave modelin e tregut të energjisë elektrike, të tillë si blerësi i vetëm ose modele dypalëshe të kontratave për strukturimin e tregut dhe metodën e mandatimit të hyrjes për personat e tretë për klientët e kualifikuar, në përputhje me Direktivën 96/92/ të Bashkimit Europian.

2. Këshilli i Ministrave vlerëson propozimet e ERE-së dhe përcakton modelin e tregut, jo më vonë se data 31 mars 2004.

Neni 54

Miratimi i rregullave të tregut

Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të modelit të tregut të energjisë elektrike, ERE-ja bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë për diskutimin dhe miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike, përfshirë rregullat që drejtojnë programimin, dispeçerimin, ruajtjen e ekuilibrit dhe kërkesat e rezervës.

Neni 55

Tregu rajonal i energjisë elektrike

1. ERE-ja bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë për të hartuar Kodin e Funkcionimit të Rrjetit, Kodin e Funkcionimit të Shpërndarjes, Kodin e Matjes, rregullat e interkonjeksionit që përputhen me standardet ndërkombëtare, si dhe kërkesat e një tregu rajonal, përfshirë protokollet e tranzitit, kërkesat e traktatit të kartës së energjisë.

2. ERE-ja nis këtë proces bashkëpunimi jo më vonë se data 1 korrik 2004. Kodi i Funkcionimit të Rrjetit, Kodi i Funkcionimit të Shpërndarjes, Kodi i Matjes, si dhe standardet e interkonjeksionit miratohen nga ERE-ja jo më vonë se data 31 dhjetor 2004.

PJESA E SHTATË TË DREJTAT E PRONËSISË

Neni 56

Të drejtat e pronësisë së të licencuarit

1. Për sigurimin e shërbimit me energji elektrike, i licencuari mund të kërkojë përdorimin e njërit prej tagrave të pronësisë ose vetë të drejtën e pronësisë së të tretëve si më poshtë:

- a) të drejtën për linjat;
- b) të drejtën e përdorimit;
- c) të drejtën e servitutit;
- ç) shpronësimin.

2. Kur ushtrohen të drejtat, sipas pikës 1 të këtij neni, dëmet e shkaktuara nga:

- a) vendosja e shenjave, matjeve, testeve;
- b) instalimi i pajisjeve, aksesi në to si dhe kryerja e punës në to;
- c) pengimi ose kufizimi për përdorimin e pronësisë,

rimbursohen nga i licencuari për pronarin ose përdoruesin e pasurisë, sipas Kodit Civil Titulli VI Kreu II dhe neneve 23 dhe 27-37 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

3. Në zonat natyrore të mbrojtura, të drejtat e përfshira në pikën 1 të këtij neni mund të jepen me miratimin paraprak të autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës, në përputhje me ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”. Në zonat që gëzojnë mbrojtje lokale nevojitet miratimi paraprak i bashkisë ose komunës përkatëse.

4. Në rast të shuarjes së të drejtave, sipas pikës 1 të këtij neni, i licencuari rivendos gjendjen e mëparshme të pronësisë.

Neni 57

E drejta për linjat

1. Të licencuarit i jepet e drejta për linjat, për instalimin dhe funksionimin e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes mbi pronën e të tretit, me kusht që kjo të mos pengojë përdorimin e pronës.

2. Për transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike në pronën e të tretit i licencuari kryen veprimet si më poshtë:

- a) instalon nën e mbi tokë linja elektrike dhe lidhje telekomunikacioni;
- b) instalon strukturat mbështetëse, pajisjet e transformimit dhe ato kyçese të vendosura mbi to;
- c) shfrytëzon, mban, riparon, transformon dhe heq pajisjet e instaluara, sipas shkronjave “a” dhe “b” të këtij neni;
- ç) heq pemët, shkurret, degët e tyre dhe rrënjët e vendosura përgjatë linjave, që dëmtojnë zonën e sigurisë;
- d) mund t’u afrohet dhe të kalojë në rrugët e transportit, të lumenjve, në rrjedhjet e ujërave, liqenet, kanalet dhe ndërtesat, sipas procedurave të parashikuara në rregulloret teknike dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 58

E drejta e përdorimit

1. Pjesët e centralit të prodhimit të energjisë elektrike, pajisjet e sistemit të transmetimit, shpërndarjes dhe ato ndihmëse mund të vendosen, të përdoren dhe të mirëmbahen në pronën e të tretit, në bazë të të drejtës së përdorimit të përkohshëm.

2. E drejta e përdorimit të përkohshëm rregullohet sipas neneve 27-37 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

Neni 59

E drejta e servitutit

Në përputhje me dispozitat e Titullit VI Kreu II të Kodit Civil, i licencuari mund të kërkojë marrjen e të drejtës së servitutit për vendosjen e rrugëkalimeve të përkohshme, që përdoren për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve, nënstacioneve, linjave të transmetimit të energjisë elektrike dhe strukturave të tyre mbështetëse në pronën e personit të tretë.

Neni 60

Shpronësimi

1. Për ngritjen e centraleve, të nënstacioneve, të kabinave elektrike dhe të linjave të transmetimit të energjisë elektrike, i licencuari mund të nisë shpronësimin e pronës së një personi të tretë, në përputhje me nenin 8 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

2. Nisja e procedurës së shpronësimit për vendosjen dhe shfrytëzimin e rrjeteve të transmetimit e të shpërndarjes dhe të strukturave të tyre mbështetëse, mund të kërkohet vetëm nëse e drejta për linjat, sipas pikës 2 të nenit 57 të këtij ligji, pengon ose ndërpret përdorimin e rregullt të pronës.

3. Procedura e shpronësimit mund të fillojë për vendosjen dhe funksionimin e pajisjeve të transformimit dhe të kyçjes të vendosura jo mbi një strukturë mbështetëse, që i përket impiantit të energjisë elektrike, vetëm nëse palët nuk bien dakord për të drejtën e përdorimit, sipas nenit 58 të këtij ligji ose nëse autoritetet përgjegjëse të rregullimit të territorit nuk e kanë miratuar.

Neni 61

Të drejtat që lidhen me linjën e drejtpërdrejtë

Për ngritjen, mirëmbajtjen dhe përfundimin e të drejtave për vendosjen dhe shfrytëzimin e linjës së drejtpërdrejtë, zbatohen dispozitat e Kodit Civil që merren me kufizimin e pronësisë së të tretëve.

Neni 62
Zonat e sigurisë

1. Për mbrojtjen e centraleve, të nënstacioneve dhe të linjave të transmetimit të energjisë elektrike dhe mjedisit rrethues, përreth tyre përcaktohet një zonë sigurie.

2. Këshilli i Ministrave miraton me vendim shtrirjen e zonës së sigurisë dhe ndalimet e kufizimet që vendosen në këtë zonë.

3. Brenda zonës së sigurisë ndalohet ngritja e ndërtesave ose objekteve të tjera, mbjellja e bimëve, pemëve, si dhe kufizohet, në përputhje me rregullat e përcaktuara, kryerja e veprimtarive që mund të rrezikojnë sigurinë dhe funksionimin e centralit elektrik, nënstacioneve, linjave ajrore ose kabllore, jetën, shëndetin ose mbrojtjen e pronësisë.

**PJESA E TETË
DISPOZITA TË TJERA**

Neni 63
Kontrollet

ERE-ja, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji, ka të drejtë të kontrollojë zbatimin e çdo fakti, kushti, praktike ose çështjeje të nevojshme ose të përshtatshme, për të përcaktuar nëse një person ka shkelur një nga dispozitat e këtij ligji, një rregull ose një urdhër që rrjedh nga ato.

Neni 64
Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga ERE-ja si më poshtë:

a) mosdërgimi në afat i raportit ekonomiko-financiar dhe i treguesve teknikë, sipas sistemit të përcaktuar nga ERE-ja, dënohet me gjobë në shumën 150 000 lekë;

b) mosshlyerja e detyrimeve financiare ndaj ERE-së, në afatet kohore të përcaktuara nga ERE-ja, dënohet me gjobë në shumën 400 000 lekë;

c) moszbatimi i vendimeve të ERE-së për tarifatat dhe çmimet, dënohet me gjobë në shumën 300 000 lekë;

ç) moszbatimi i kushteve të përcaktuara në licencë, sipas pikës 2 të nenit 18 të këtij ligji, dënohet me gjobë në shumën 350 000 lekë.

2. Në rast shkeljeje të përsëritur të dispozitave të këtij ligji ose rregulloreve të miratuara, ERE-ja, në përputhje me autoritetin e vet ligjor, sipas nenit 19 të këtij ligji, i heq licencën personit, që kryen shkeljet.

3. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen sipas Kodit të Procedurave Administrative.

4. Gjoha është titull ekzekutiv që vilet nga ERE-ja dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit. Ngarkohen zyrat e përmbarimit për ekzekutimin e tyre.

Neni 65
Dispozitë kalimtare

Procedura për zgjedhjen e Bordit të ri të ERE-së fillon më 1 shtator 2003.

Neni 66
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 32, 36, 53 dhe 62 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Energjisë Elektrike të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 14, 20, 21, 24, 26, 44, 53, 54 dhe 55 të këtij ligji.

Neni 67
Shfuqizimi i ligjeve të tjera

Ligji nr.7962, datë 13.7.1995 "Për energjinë elektrike" dhe ligji nr.7970, datë 20.7.1995 "Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike", shfuqizohen.

Neni 68
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3854, datë 20.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9073, datë 29.5.2003

PËR PRIVATIZIMIN E SHOQËRISË
"UZINA MEKANIKE E NAFTËS" SHPK, KUÇOVË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Shoqëria "Uzina Mekanike e Naftës" shpk, Kuçovë i nënshtrohet privatizimit.

Privatizimi i kësaj shoqërie bëhet në përputhje me legjislacionin për privatizimin e sektorëve jostrategjikë.

Neni 2

Të ardhurat që do të përfitohen nga privatizimi i "Uzinës Mekanike të Naftës" shpk Kuçovë ndahen si më poshtë:

1. Punonjësve të "Uzinës Mekanike të Naftës" shpk, Kuçovë, që dalin të papunë gjatë procesit të privatizimit, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, u jepet një pagesë e barabartë me pagën e dy viteve dhe paguhen kontributet e papaguara të sigurimeve shoqërore.

2. Pjesa tjetër e të ardhurave derdhet në Buxhetin e Shtetit.

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për formën dhe strukturën e formulës së privatizimit të shoqërisë “Uzina Mekanike e Naftës” shpk, Kuçovë.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3855, datë 20.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J

Nr.9074, datë 29.5.2003

PËR SHËRBIMIN INFORMATIV USHTARAK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat dhe fushën e veprimtarisë së Shërbimit Informativ Ushtarak (SHIU).

Neni 2

Misioni

SHIU grumbullon, analizon dhe administron të dhëna për veprimtaritë, që cenojnë sigurinë kombëtare, kërcënime të mundshme ose rreziqe ndaj Forcave të Armatosura, që vijnë nga jashtë ose shfaqen brenda vendit, për t'i paraqitur tek autoritetet e drejtimit dhe të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura, për t'i mbështetur gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre.

Neni 3

Parimet e veprimtarisë

Parimet e organizimit dhe të funksionimit të SHIU-t janë ligjshmëria, sekreti, objektiviteti, bashkëveprimi ndërinstytucional dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 4

Organizimi

1. Shërbimi Informativ Ushtarak është organ i depolitizuar, i specializuar informativ me organizim unik e të centralizuar, i shtrirë në territorin, ku kryejnë misionin Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, brenda dhe jashtë vendit.

2. SHIU organizohet dhe funksionon si strukturë në nivel drejtorie në Ministrinë e Mbrojtjes dhe me struktura varësie në territoret ku kryejnë veprimtarinë Forcat e Armatosura.

3. Struktura, organika analitike dhe rregullat e funksionimit të SHIU-t përcaktohen nga Ministri i Mbrojtjes dhe miratohen nga Kryeministri.

4. SHIU ka emblemën dhe stemën e vet, të miratuara nga Ministri i Mbrojtjes.

Neni 5

Detyrat

SHIU, në zbatim të misionit të tij, kryen dhe realizon këto detyra:

a) grumbullon, analizon dhe paraqet informacion për veprimtari, të cilat kërcënojnë e rrezikojnë integritetin e vendit, rendin kushtetues, planet ushtarake mbrojtëse dhe realizimin e misionit të Forcave të Armatosura;

b) grumbullon, analizon dhe paraqet informacion për veprimtari, që lidhen me spiunazhin, terrorizmin, sabotazhin, subversionin në drejtim të Ministrisë së Mbrojtjes e të Forcave të Armatosura dhe për çdo veprimtari, që kërcënon sigurinë dhe stabilitetin e shtetit;

c) paraqet informacione dhe vlerësime për gjendjen e sigurisë në Ministrinë e Mbrojtjes e në Forcat e Armatosura;

ç) merr pjesë në procedurat për pajisjen me certifikatë sigurie të personelit ushtarak dhe civil të Ministrisë së Mbrojtjes e të Forcave të Armatosura, si dhe të subjekteve që kanë marrëdhënie me to;

d) merr pjesë në edukimin e personelit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura për çështje të veprimtarisë së SHIU-t;

dh) garanton sigurinë e veprimtarisë së vet, të dhënave të personelit dhe të pasurisë që ka në zotërim, duke përfshirë verifikimin e kandidatëve, të punësuarve dhe të kontraktuesve;

e) kryen veprimtari mbështetëse tekniko-administrative për interes të vet.

Neni 6

Ministri

Ministri i Mbrojtjes është autoriteti përgjegjës për veprimtarinë e SHIU-t dhe përcakton politikat e tij, në përputhje me politikat shtetërore, duke siguruar bashkërendimin ndërmjet këtij shërbimi dhe komponentëve të tjerë, zbulues në Forcat e Armatosura, si dhe në marrëdhëniet me institucionet e tjera. Ministri i Mbrojtjes:

a) nxjerr urdhra dhe udhëzime për organizimin dhe veprimtarinë informative të shërbimit;

b) mbron burimet e të dhënave dhe metodat nga ekspozimi i paautorizuar;

c) njofton, të paktën një herë në vit, për veprimtarinë e SHIU-t te Kryeministri dhe Presidenti, si dhe në rastet kur kërkohet prej tyre;

ç) propozon procedura të veçanta për klasifikimin dhe deklasifikimin e të dhënave që përbëjnë sekret shtetëror të SHIU-t;

d) përcakton partneritetin me shërbimet informative të huaja, në bazë të politikave të bashkëpunimit, të miratuara nga Qeveria.

Neni 7

Drejtori i SHIU-t

1. Drejtori i SHIU-t emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të SHIU-t janë:

a) përgjigjet për realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të SHIU-t, kryen kontrollin për plotësimin e tyre dhe siguron zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e këtij shërbimi;

b) njofton Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, komandantët e komandave të forcave e të mbështetjes, si dhe u shërben nevojave të tyre për veprimtarinë e SHIU-t, në fushën e vet të përgjegjësisë;

- c) organizon, me miratimin e Ministrit të Mbrojtjes, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me shërbimet informative vendase dhe të huaja;
- ç) bashkërendon punën me strukturat e tjera të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura, veprimtaritë e të cilave ndikojnë në fushën e përgjegjesisë së SHIU-t;
- d) organizon dhe ndjek kualifikimin e punonjësve të shërbimit.

Neni 8

Personeli i SHIU-t

Personeli ushtarak, që shërben në strukturat e SHIU-t, gëzon statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura, ndërsa personeli civil gëzon statusin e nëpunësit civil.

Kriteret e pranimit, karriera dhe ndërprerja e saj përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 9

Bashkëpunimi me Shërbimin Informativ Shtetëror

Ministri i Mbrojtjes dhe Drejtori i Shërbimit Informativ Shtetëror (SHISH) përcaktojnë bashkëpunimin ndërmjet SHISH-it dhe SHIU-t, në bazë të politikave të miratuara nga Kryeministri.

Neni 10

Bashkëpunimi me institucionet shtetërore e private

Për realizimin e misionit të vet, SHIU bashkëpunon me institucionet shtetërore dhe private, duke marrë prej tyre, sipas ligjit, asistencën e nevojshme dhe të dhënat që ata zotërojnë.

Neni 11

Bashkëpunimi me persona

SHIU, për plotësimin e misionit, krijon marrëdhënie bashkëpunimi me kontratë me persona të caktuar, me pëlqimin e tyre, të cilat mbrohen nga ky ligj dhe akti nënligjor përkatës i Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 12

Procedurat

SHIU e ushtron veprimtarinë në përputhje me procedurat e miratuara nga Ministri i Mbrojtjes dhe të pranuarat e të nënshkruarata nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili ka të drejtë të ushtrojë kontroll për zbatimin e këtyre procedurave.

Neni 13

Burimet financiare

1. SHIU ka dhe përdor buxhetin e vet, brenda buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për përdorimin dhe kontrollin e fondeve publike nuk zbatohen për veprimtari specifike të shërbimit.

Përdorimi dhe kontrolli i këtyre fondeve të veprimtarisë informative rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Ndalimi i veprimtarisë policore

SHIU-t i ndalohet të kryejë veprimtari të karakterit policor.

Neni 15

Ndalimi i veprimtarisë jashtë misionit

Ndalohet kryerja e veprimeve për të realizuar qëllime dhe objektiva, që nuk kanë lidhje me misionin e shërbimit.

Neni 16

Informacionet

Informacionet e grumbulluara nga SHIU nuk përbëjnë bazë ligjore për kufizimin e lirive dhe të të drejtave themelore të njeriut, si dhe të interesave të personave fizikë e juridikë.

Neni 17

Përfundimi nga publikimi

SHIU përfundohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të të dhënave, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të personelit.

Neni 18

Kontrolli nga Kuvendi

1. Veprimtaria e SHIU-t kontrollohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet komisionit parlamentar të përhershëm në fushën e mbrojtjes.

2. Ministri i Mbrojtjes raporton, për veprimtarinë e SHIU-t, përpara komisionit parlamentar të përhershëm në fushën e mbrojtjes, të paktën një herë në vit, si dhe sa herë që kërkohet prej Komisionit.

3. Raportimet bëhen dhe administrohen duke ruajtur burimet dhe informacionet e klasifikuara, sipas ligjislacionit në fuqi.

Neni 19

Arkivi

Për përpunimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumenteve të krijuara gjatë veprimtarisë, SHIU krijon arkivin e vet, si pjesë e veçantë e sistemit arkivor të Ministrisë së Mbrojtjes.

Dokumentacioni ekzistues kalon në dispozicion të SHIU-t.

Neni 20

Aktet nënligjore

Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji ngarkohen për nxjerrjen e akteve nënligjore Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit 13, Kryeministri, në zbatim të neneve 4 pika 3 dhe 9 dhe Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të neneve 4 pika 4, 6, 7, 11 dhe 12.

Neni 21

Dispozita kalimtare

Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga miratimi i këtij ligji, të përgatisë projektligjin për kriteret e pranimit, karrierën dhe ndërprerjen e saj.

Deri në daljen e këtyre akteve, në zbatim të këtij ligji, do të vazhdojnë të zbatohen aktet nënligjore në fuqi, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr. 3856, datë 20.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9075, datë 29.5.2003

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË TERMAVE KRYESORË TË ZGJIDHJES SË
BORXHIT TË JASHTËM TË TRASHËGUAR, TË PAPAGUAR TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohen kriteret dhe termat kryesorë të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të trashëguar, të papaguar të Shqipërisë si më poshtë:

I. Borxhi i jashtëm i trashëguar, i papaguar i Republikës së Shqipërisë konsiderohet borxhi që rrjedh:

a) nga zbatimi i marrëveshjeve në kuadrin e shkëmbimeve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera (borxhi në klering);

b) nga transaksionet e import-eksportit të papaguara dhe të pakonfirmuara, të kryera nga ish-ndërmarrjet e tregtisë së jashtme me firmat dhe kompanitë e huaja;

c) nga marrëveshjet e lidhura ndërmjet bankave shqiptare, si përfaqësuese të Shtetit Shqiptar dhe bankave të huaja,

ç) nga transaksionet e import-eksportit të garantuara nga organizma ndërkombëtarë ose nga institucionet përkatëse të Qeverisë Shqiptare.

Ky borxh përfshin vetëm detyrimet e konstatuara ose të kërkuara, që i referohen veprimeve që janë kryer deri më 31.12.1992.

II. Termat e Referencës (ToR) për zgjidhjen e borxhit të jashtëm për përfundimin e marrëveshjeve me çdo kreditor janë:

a) për borxhin e jashtëm të trashëguar kundrejt vendeve anëtare të Klubit të Parisit, janë Termat e Referencës të përcaktuara nga Klubi i Parisit;

b) për borxhin e jashtëm ndaj kreditorëve të tjerë, që nuk janë anëtarë të Klubit të Parisit, përdoren kriteret e mëposhtme:

(i) kthimi i borxhit të trashëguar në borxh shtetëror mbi bazën e marrëveshjeve qeveritare me kushte lehtësuese, ku elementi grant, që do të rezultojë nga Termat e Referencës, të mos jetë më i vogël se 35 për qind;

(ii) eliminimi i interes-vonesave;

(iii) zbatimi i zgjidhjeve jo më pak favorizuese se zgjidhja e arritur me disa kreditorë të jashtëm para hyrjes në fuqi të këtij ligji;

(iv) zbatimi i zgjidhjeve jo më pak favorizuese se zgjidhja, kur shlyerja parashikohet të bëhet kundrejt eksportimit të mallrave brenda një periudhe kohore prej jo më pak se 10 vjetësh.

III. Afati i përfundimit të marrëveshjeve.

Marrëveshjet bilaterale për zgjidhjen e borxhit të jashtëm të përfundohen deri më 31.12.2004.

Neni 2

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore për zbatimin, rast pas rasti, të termave dhe kritereve për zgjidhjen e borxhit të jashtëm të trashëguar të Shqipërisë.

Neni 3

Ngarkohet Komiteti Qeveritar i Bisedimeve të Borxhit të Jashtëm, me cilësinë e përfaqësuesit të Shtetit Shqiptar, të realizojë zbatimin e kritereve dhe termave të përgjithshëm të zgjidhjes së borxhit të jashtëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të nxjerrë rregullat dhe udhëzimet përkatëse për caktimin e procedurave për rakordimin e borxhit të jashtëm.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3857, datë 20.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9076, datë 9.6.2003

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BASHKIMIT EUROPIAN PËR VEPRIMTARITË E MISIONIT VËZHGUES TË
BASHKIMIT EUROPIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European për veprimtaritë e Misionit Vëzhgues të Bashkimit European në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3870, datë 30.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN
MBI AKTIVITETET E MISIONIT VËZHgues TË BASHKIMIT EUROPIAN
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Republika e Shqipërisë, më poshtë e quajtur Palë Pritëse, dhe Bashkimi European, së bashku të quajtura Palë Pjesëmarrëse, duke mbajtur parasysht:

- prezencën e Misionit Vëzhgues të Komunitetit European (ECMM) në Ballkanin Perëndimor që në vitin 1991;

- marrëveshjen mbi zgjatjen dhe zgjerimin e aktivitetit të Misionit Vëzhgues në Jugosllavi, nënshkruar në Hagë, më 14 tetor 1991;

- memorandumimin e mirëkuptimit të Misionit Vëzhgues të Bashkimit European në zonën e kufirit të Shqipërisë me ish-Jugosllavinë, nënshkruar në Tiranë më 21 dhjetor 1992;

- prezencën e monitoruesve të Komunitetit European/Bashkimit European në Republikën e Shqipërisë që në vitin 1992;

- miratimin nga Këshilli European më 22 dhjetor 2000 të Aktit të Përbashkët 2000/811/PPJS mbi Misionin Vëzhgues të Bashkimit European, transformimin e ECMM-së në EUMM, si një instrument të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, bazuar në iniciativat e mëparshme, të kontribuojë në formulimin efektiv të politikës së Bashkimit European për vendet e Ballkanit Perëndimor;

- zgjerimin e mandatit të Misionit Vëzhgues të Bashkimit European (EUMM) me Aktin e Përbashkët 2001/845/PPJS të datës 29 nëntor 2001,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Mandati

1. Misioni Vëzhgues i Bashkimit European, më poshtë i quajtur "EUMM" më parë i njohur në rajon si Misioni Vëzhgues i Komunitetit European (ECMM), me zyrën e tij qendrore të vendosur në Sarajevë, do të vendosë zyrën e Misionit të tij në Tiranë dhe zyra të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë, në bazë të vendimit të shefit të Misionit dhe në marrëveshje dhe konsultim me Palën Pritëse, me qëllim që të kontribuojë në një formulim sa më efektiv të politikës së Bashkimit European për vendet e Ballkanit Perëndimor.

2. EUMM, do të veprojë në përputhje me mandatin e tij të parashikuar në aktin e përbashkët që rregullon EUMM-në.

3. Pala Pritëse do t'i ofrojë EUMM-së të gjithë informacionin dhe bashkëpunimin e nevojshëm për realizimin e objektivave të EUMM-së. Pala Pritëse mund të caktojë një person kontakti pranë EUMM-së.

Neni 2
Statusi

1. Pala Pritëse do të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen, sigurinë dhe sigurimin e anëtarëve të EUMM-së. Për ndonjë kusht të veçantë, të propozuar nga Pala Pritëse, do të bihet dakord me shefin e Misionit para zbatimit të Marrëveshjes.

2. Me qëllim kryerjen e aktiviteteve të tij, EUMM-ja dhe personeli i tij do të gëzojnë, së bashku me automjetet dhe pajisjet e tyre, liri lëvizjeje të nevojshme për të realizuar mandatin e Misionit.

3. Gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, personeli i EUMM-së mund të shoqërohet nga një përkatës dhe, me kërkesën e tij, nga një shoqërues të përcaktuar nga Pala Pritëse.

4. EUMM-ja mund të përdorë flamurin e Bashkimit European në zyrat e Misionit në Tiranë dhe përndryshe në vende të tjera, sipas vendimit të shefit të Misionit.

5. Automjetet dhe mjetet e tjera të transportit të EUMM-së do të mbajnë shenjën dalluese të identifikimit të Misionit, i cili do t'u bëhet i njohur autoriteteve përkatëse.

Neni 3 Përbërja

1. Shefi i Misionit emërohet nga Këshilli i Bashkimit European.
2. Personeli tjetër i Misionit përcaktohet nga vendet anëtare të Bashkimit European. Ata do të emërohen në postet specifike nga shefi i Misionit që vepron nën autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm/Përfaqësuesit të Lartë. Norvegjia dhe Sllovakia, që në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje personeli, dhe së bashku me Bashkimin European dhe vendet anëtare, do të formojnë Palët Dërguese.
3. Personeli i Misionit Vëzhgues do të quhet monitorues.
4. Qeveritë e Palëve Dërguese do të caktojnë monitoruesit në EUMM.
5. Shefi i Misionit do të përcaktojë numrin e monitoruesve në këtë Marrëveshje, mbi bazën e konsultimit dhe marrëveshjes me Palën Pritëse.
6. Monitoruesit nuk do të ndërmarrin ndonjë veprim ose aktivitet që nuk përputhet me natyrën e detyrës së tyre.
7. EUMM-ja mund të shfrytëzojë asistencën e stafit teknik dhe administrativ të Palëve Dërguese. Anëtarët e stafit teknik dhe administrativ të EUMM-së do të gëzojnë një status të barabartë me atë që gëzon stafi administrativ dhe teknik i punësuar në ambasada nga Palët Dërguese, në përputhje me Konventën e Vienës mbi marrëdhëniet diplomatike.
8. Misioni Vëzhgues mund të rekrutojë një personeli ndihmës vendas, sipas nevojave. Në bazë të kërkesës së shefit të misionit, Pala Pritëse do të krijojë lehtësira për rekrutimin nga ana e Misionit të një personeli vendas të kualifikuar. Personeli ndihmës i Misionit EUMM do të gëzojë status të njëjtë me atë që gëzon në përputhje me Konventën e Vienës mbi marrëdhëniet diplomatike, stafi vendas i ambasadave.

Neni 4 Armët dhe veshja

1. Monitoruesit nuk mund të mbajnë armë.
2. Monitoruesit do të mbajnë veshje të bardhë civile me shenjën dalluese të EUMM-së.

Neni 5 Shkalla e përgjegjësisë

1. Misioni Vëzhgues në Shqipëri do të veprojë nën përgjegjësinë e shefit të Misionit.
2. Shefi i Misionit do të raportojë rregullisht, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm/Përfaqësuesit të Lartë, në Këshillin e Bashkimit European mbi aktivitetet dhe rezultatet e Misionit.
3. Detyrat e EUMM-së do të përcaktohen nga Sekretari Përgjithshëm/Përfaqësuesi i Lartë në bashkëpunim të ngushtë me Presidencën dhe në përputhje me politikën e adaptuar nga Këshilli European për vendet e Ballkanit Perëndimor.
4. Shefi i Misionit do të informojë rregullisht Palën Pritëse mbi aktivitetet e EUMM-së.

Neni 6 Udhëtimi dhe transporti

1. Automjetet dhe mjetet e tjera të transportit të EUMM-së nuk do të jenë subjekt i detyrueshëm regjistrimi ose licencimi dhe të gjitha mjetet do të kenë sigurimin e një pale të tretë.
2. Misioni Vëzhgues mund të përdorë rrugë, ura, kanale, lehtësi portuale dhe aeroportuale, pa pagim të taksave ose tatimeve.
3. Pala Pritëse do t'i krijojë lehtësira Misionit Vëzhgues në përdorimin e automjeteve të tij dhe mjeteve të tjera të transportit.

Neni 7
Komunikimi

1. Personeli i EUMM-së gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tij do të ketë akses, me koston më të ulët, në përdorimin e pajisjeve përkatëse të telekomunikimit të Palës Pritëse, përfshirë komunikimin me përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Palëve Dërguese.

2. EUMM-ja do të gëzojë të drejtën e komunikimit të pakufizuar nëpërmjet radiove të tij (përfshirë ato satelitore, të lëvizshme dhe portative), telefonave, telegrafëve, faksit dhe mjeteve të tjera. Pala Pritëse do të ofrojë, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, frekuencat e radiove në të cilat do të veprojnë.

Neni 8
Privilegjet dhe imunitetet

1. EUMM-së do t'i jepet statusi i Misionit Diplomatik.

2. Monitoruesve, gjatë misionit të tyre, do t'u akordohen privilegjet dhe imunitetet e agjentit diplomatik në përputhje me Konventën e Vienës për marrëdhëniet diplomatike.

3. Zyra e Misionit në Tiranë, zyra të tjera dhe gjithë mjetet e transportit të Misionit EUMM do të jenë të padhunueshme.

4. Privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara nga ky nen do t'u jepen monitoruesve gjatë misionit të tyre, dhe më pas, për akte të kryera më parë gjatë misionit të tyre.

5. Pala Pritëse do të krijojë lehtësira për lëvizjen e shefit të Misionit dhe personelit të EUMM-së. Misioni do t'i ofrojë Palës Pritëse një listë të anëtarëve të tij dhe do ta informojë Palën Pritëse paraprakisht mbi arritjen dhe largimin e personelit që i përket Misionit. Personeli që i përket Misionit Vëzhgues do të mbajë pasaportat përkatëse kombëtare, si dhe një kartë identiteti të Misionit.

6. Pala Pritëse njih të drejtën e Palëve Dërguese dhe të EUMM-së për të importuar pa taksa ose kufizime të tjera, pajisje, furnizime ose mallra të tjera që nevojiten për përdorim ekskluziv dhe zyrtar të Misionit. Pala Pritëse njih gjithashtu të drejtën e blerjes të sendeve të tilla në territorin e Palës Pritëse, si dhe të eksportimit të pajisjeve të tilla, furnizimeve dhe mallrave të tjera që janë blerë në këtë mënyrë ose janë importuar. Pala Pritëse njih gjithashtu të drejtën e monitoruesve për të blerë dhe/ose importuar pa taksa apo kufizime të tjera të sendeve për përdorim personal dhe për t'i eksportuar këto sende.

Neni 9
Strehimi dhe rregullime të tjera praktike

Qeveria e Republikës së Shqipërisë pranon, nëse i kërkohet, që të ndihmojë EUMM-në në gjetjen e zyrave dhe strehimit të përshtatshëm. Palët Pjesëmarrëse do të vendosin mbi masa të tjera që lidhen me privilegjet dhe imunitetet dhe për rregullime të tjera praktike, që përfshijnë ndihmën mjekësore dhe evakuimin urgjent, si dhe mbi kërkesat e dokumentacionit të udhëtimit.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht që nga data e nënshkrimit dhe do të hyjë në fuqi, kur EUMM-ja do të marrë njoftimin me shkrim nga Pala Pritëse se janë plotësuar procedurat e saj të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ajo do të mbetet në fuqi deri në atë kohë kur njëra nga Palët Pjesëmarrëse njofton Palën tjetër, dy muaj përpara, se ajo synon t'i japë fund aktiviteteve të përmendura në këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 28 mars 2003 në gjuhët shqip dhe anglisht, të gjitha të barasvlefshme. Në rast ndryshimesh në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

L I G J
Nr.9078, datë 9.6.2003

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8899, DATË 22.5.2002
"PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË INSIG,
SHA"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në fund të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr.8899, datë 22.5.2002 "Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG, sha", shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Këshilli i Ministrave ka të drejtë të zgjasë afatin e parashikuar në këtë pikë deri në 6 muaj."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr. 3872, datë 30.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9079, datë 9.6.2003

PËR SHFUQIZIMIN E LIGJIT NR.8720, DATË 26.12.2000
"PËR KRIJIMIN E POLICISË FINANCIARE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ligji nr.8720, datë 26.12.2000 "Për krijimin e Policisë Financiare", shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3873, datë 30.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9081, datë 19.6.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR DORËZIMIN E PERSONAVE NË GJYKATËN NDËRKOMBËTARE PENALE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për dorëzimin e personave në Gjykatën Ndërkombëtare Penale", nënshkruar në Tiranë më 2.5.2003.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr. 3869, datë 30.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË LIDHJE ME DORËZIMIN E PERSONAVE NË GJYKATËN NDËRKOMBËTARE PENALE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në vazhdim "Palët":

duke afirmuar rëndësinë e sjelljes përpara drejtësisë të personave që kryejnë genocid, krime kundër njerëzimit, si dhe krime lufte;

duke rikujtuar që Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale i përpiluar në Romë, më 17 korrik 1998, nga konferenca diplomatike e të plotfuqishmëve të Kombeve të Bashkuara për krijimin e një Gjykate Ndërkombëtare Penale, ka për qëllim të plotësojë dhe jo të zëvendësojë juridiksionin penal kombëtar;

duke pasur parasysh që secila prej palëve ka shprehur synimin e saj për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht, kur e shohin me vend, veprimet brenda juridiksionit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për të cilat pretendohet se janë kryer nga zyrtarët, nëpunësit, personeli ushtarak apo nënshitetasit e tjerë të tyre;

duke pasur parasysh nenin 98 të Statutit të Romës, bien dakord si më poshtë:

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, "persona" janë zyrtarë të tanishëm apo të mëparshëm të Qeverisë, të punësuar (përfshirë edhe kontraktuesit) ose personel ushtarak apo nënshitetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

2. Personat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mungesë të miratimit të shprehur prej Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës:

a) nuk do të dorëzohen apo nuk do të transferohen në asnjë mënyrë në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për çfarëdo qëllimi ose

b) nuk do të dorëzohen apo nuk do të transferohen në asnjë mënyrë në një entitet tjetër ose vend të tretë apo të dëbohen në një vend të tretë, me qëllim dorëzimit apo transferimit në Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

3. Kur Qeveria e Republikës së Shqipërisë ekstradon, dorëzon ose ndryshe transferon një person të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në një vend të tretë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk do të pranojë dorëzimin apo transferimin e këtij personi në Gjykatën Ndërkombëtare Penale nga një vend i tretë, pa miratimin e shprehur të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

4. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me një shkëmbim notash, të cilat do të konfirmojnë që secila Palë ka përmbushur kërkesat e domosdoshme të legjislacionit të brendshëm për ta sjellë Marrëveshjen në fuqi. Do të vazhdojë të jetë në fuqi deri një vit pas datës, kur njëra Palë njofton tjetrën për synimin e saj për t'i dhënë fund kësaj Marrëveshjeje. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë të vlefshme për çdo akt që do të kryhet apo çdo akuzë që do të ngrihet, përpara datës efektive të mbarimit të Marrëveshjes.

Përfunduar në Tiranë, në dublikatë, më datë 2 maj 2003 në gjuhët shqipe dhe angleze. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, do të merret parasysh teksti në gjuhën angleze.

V E N D I M
Nr.77, datë 17.6.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.72, DATË 17.3.2003 "PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E
VEPRIMTARISË SË QEVERISË PËR TRANSPARENCËN E PROCESIT TË FIRMAVE
PIRAMIDALE NË BAZË TË LIGJIT NR.8215, DATË 9.5.1997 "PËR KONTROLLIN
FINANCIAR TË PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA
PUBLIKU I GJERË""**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit",

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Pika III e vendimit të Kuvendit nr.72, datë 17.3.2003 "Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për hetimin e veprimtarisë së Qeverisë për transparencën e procesit të firmave piramidale në bazë të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë" ndryshohet si më poshtë:

"III. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij deri më datë 7.7.2003".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

V E N D I M
Nr.78, datë 17.6.2003

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR, KONKLUZIONEVE DHE
REKOMANDIMEVE TË KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR TË NGRITUR ME
VENDIMIN NR.70, DATË 10.3.2003**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit",

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet Raporti Përfundimtar, konkluzionet dhe rekomandimet e Komisionit Hetimor të Kuvendit, të ngritur me vendimin nr.70, datë 10.3.2003 "Për shqyrtimin e ligjshmërisë së përdorimit të fondeve publike dhe të të ardhurave të tjera në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Bashkinë e Tiranës për periudhën 1992-2002, si dhe zbatimin e ligjshmërisë për zhvillimin urbanistik në Tiranë për periudhën 1992-2002", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Raportit Përfundimtar i bashkëlidhet mendimi i pakicës, sipas nenit 21 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit".

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

R E Z O L U T Ë

Duke vlerësuar se niveli aktual i marrëdhënieve midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë është shumë i mirë dhe se mundësitë për një intensifikim të bashkëpunimit në hapësirat politike, ekonomike, diplomatike, ushtarake dhe kulturore midis dy vendeve janë shtuar ndjeshëm në frymën e përgjithshme të integritit europian dhe euroatlantik;

Duke konsideruar se Greqia si vend fqinj, anëtar i BE-së dhe i NATO-s, përbën një partner shumë të rëndësishëm në rrugën e Shqipërisë për arritjen e objektivit madhor për integrimin në strukturat euroatlantike;

Duke konstatuar se në të dy vendet tona ekzistojnë ende disa pasoja të së kaluarës, si dhe disa probleme të pazgjidhura të lidhura me Ligjin e Luftës të vitit 1940;

Duke çmuar me kënaqësi se hyrja në fuqi e "Traktatit të miqësisë, bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë" ka hapur ligjërisht rrugën për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të gjithanshme mes dy vendeve tona;

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Inkurajon Qeverinë Shqiptare të intensifikojë përpjekjet e saj për forcimin e mëtejshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve miqësore me Greqinë.

2. Fton Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe atë të Greqisë, si dhe institucionet e tjera të dy vendeve, që mbi bazën e "Traktatit të miqësisë, të bashkëpunimit, fqinjësisë së mirë dhe sigurisë", ratifikuar nga të dy parlamentet, si dhe në frymën e mirëkuptimit të ndërsjellë, të paqes dhe prosperitetit në rajon, të kapërcejnë me ndjenjë përgjegjësie çështjet e trashëguara, pengesat përkatëse ligjore dhe të nisin punën konkrete për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me efektet e Ligjit të Luftës të vitit 1940.

3. I kërkon Qeverisë Shqiptare të përshpejtojë punën për ngritjen e grupit të posaçëm të punës, i cili, së bashku me palën greke dhe në frymën e nenit 15 të “Traktatit të miqësisë, bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë”, të punojë për heqjen e pengesave për gëzimin e pasurive të shtetasve të njëjës palë në territorin e palës tjetër.

4. Nxiti qeveritë e dy vendeve, që në frymën e konventave të Këshillit të Europës lidhur me të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, të punojnë për promovimin e këtyre të drejtave, shkollimin e ndërsjellë në gjuhën amtare të shtetasve përkatës në vendet e tyre, lehtësimin e procedurave për lëvizjen e shtetasve brenda kuadrit ligjor, si edhe përshpejtimin e legalizimit të emigrantëve shqiptarë, mbi bazën e parametrave europianë.

5. Përshëndet mbështetjen që Qeveria Greke po i jep Shqipërisë në procesin e stabilizim - asociimit për nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse me Bashkimin Europian, si dhe vlerëson përpjekjet e saj për t'i dhënë një nxitje të re këtij procesi në Samitin e Selanikut.

Tiranë, më 12 qershor 2003

D E K R E T
Nr.3866. datë 25.6.2003

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---------------------------------------|--|
| 1. Katrinë Gjeto Butsch (Elezi) | 28. Jennifer Ilirjan Xheka |
| 2. Brixhida Muharrem Ali (Osmani) | 29. Vera Hysen Xheka (Hida) |
| 3. Sofije Dylber Bode (Bixhaku) | 30. Edmond Aristidh Vaso |
| 4. Edmond Astrit Shytlari | 31. Sokol Qirjako Mino |
| 5. Lubica Tase Hallmann (Rada) | 32. Alex Sokol Mino |
| 6. Edmond Lilo Prokopi | 33. Manjola Thoma Birmelin (Qirollari) |
| 7. Samanda Edmond Prokopi | 34. Irena Tefik Homberg (Çadra) |
| 8. Violeta Dane Prokopi (Osmani) | 35. Blerina Kozma Kobelovà (Ndrio) |
| 9. Enada Edmond Prokopi | 36. Valbona Fejzi Merruko (Kuçyku) |
| 10. Blerim Naxhi Ulqinaku | 37. Pëllumb Sinan Uzuni |
| 11. Lavdërim Raim Hofbauer (Avdullai) | 38. Adnan Anastas Kike |
| 12. Adil Brahim Kaloshi | 39. Ilir Ndue Kashnjeti |
| 13. Albion Adil Kaloshi | 40. Pranvera Hasan Kapllani |
| 14. Elida Sherif Kaloshi (Haxhiraj) | 41. Mimoza Ferhat Çomo (Meta) |
| 15. Valbona Adil Kaloshi | 42. Xhesika Roland Çomo |
| 16. Dalina Millorad Verbica | 43. Geri Roland Çomo |
| 17. Gjovalin Preng Lleshi | 44. Arlind Fejzi Fejziaj |
| 18. Antonio Gjovalin Lleshi | 45. Gazmend Namik Feraizi |
| 19. Mariolina Gjovalin Lleshi | 46. Xhuliano Gazmend Feraizi |
| 20. Florinde Mark Lleshi (Ajtyresa) | 47. Manjola Mati Feraizi (Prendushi) |
| 21. Artan Sami Wöll (Dinellari) | 48. James Latif Shaba |
| 22. Arben Kastriot Hazizi | 49. Majlinda Romeo Lahaniatis (Saraçi) |

23. Arjan Lefter Çipa (Cipa)
24. Ilir Mehmet Islami
25. Piro Esat Tartari
26. Ilirjan Shaqir Xheka
27. Jonida Ilirjan Xheka

50. Jeton Fadil Gjoleka
51. Edmond Rustem Hoxha
52. Amela Edmond Hoxha
53. Bland Ali Sokoli
54. Orges Bland Sokoli

Neni 2







Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:



Doli nga shtypi më 3.7.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë